



MESHA HYJORE E ATIT TONE NDER SHENJTORET VASILIT TE MADH

Kjo meshë hyjnore kryhet në të-dielat e kreshmëve të mëdha (me përjashtim të së Dielës së Dafinës), të Enjten e Madhe dhe të shenjtë, të Shtunën e Madhe, në vigjile të Krishtlindjes dhe të Ujit të Bekuar, në rast se këto nuk `bien të shtunën ose të dielën, sepse po të bien në këto ditë të javës, atëherë Mesha e Shën Vasilit bëhet ditën e Krishtlindjes ose të Ujit të Bekuar e jo në vigjiljet e tyre, dhe ditën e kujtimit të Shën Vasilit të Madh, më 1 janar. Rregulli i Proskomidhisë është i njëjtë me atë të Meshës së Shën Joan Gojartit.

Dhiaku del nga hierorja, qëndron përpara Derës së Bukur, falet tri herë dhe thotë:

Dhiaku: Beko, o Zot.

Prifti ngre Ungjillin dhe, duke bërë me të shenjën e Kryqit mbi Andiminsin, thotë:

Prifti: E bekuar është mbretëria e Atit, e Birit dhe e Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve.

Psaltët: Amin.

Dhiaku, ose në mungesë të tij prifti, thotë:

Dhiaku: Me paqe le t'i lutemi Zotit.

Psaltët: Mëshiro, o Zot.

Dhiaku: Për paqen që lartazi dhe për shpëtimin e shpirttrave tanë, le t'i lutemi Zotit.

- Psaltët:** Mëshiro, o Zot.
- Dhiaku:** Për paqen e tërë botës, qëndrimin e mirë të Kishave të shenjta të Perëndisë, dhe për bashkimin e të gjithëve, le t'i lutemi Zotit.
- Psaltët:** Mëshiro, o Zot.
- Dhiaku:** Për këtë shtëpi të shenjtë dhe për ata që hyjnë brenda në të me besë, shpresëtari dhe frikë Perëndie, le t'i lutemi Zotit.
- Psaltët:** Mëshiro, o Zot.
- Dhiaku:** Për Kryepiskopin (*ose* episkopin) tonë (*aksh*), të nderuarën presviteri dhe dhiakonatën më Krishtin, për tërë klerin dhe popullin, le t'i lutemi Zotit.
- Psaltët:** Mëshiro, o Zot.
- Dhiaku:** Për Republikën e Shqipërisë, Qeverinë, Ushtrinë dhe gjithë popullin, le t'i lutemi Zotit.
- Psaltët:** Mëshiro, o Zot.
- Dhiaku:** Për këtë qytet (*ose* manastir të shenjtë), çdo qytet dhe vend dhe për ata që banojnë ndër to me besë, le t'i lutemi Zotit.
- Psaltët:** Mëshiro, o Zot.
- Dhiaku:** Për erëra të mira, begati të pemëve të dheut dhe për kohë me paqe, le t'i lutemi Zotit.
- Psaltët:** Mëshiro, o Zot.
- Dhiaku:** Për ata që lundrojnë, që udhëtojnë, për të sëmurët, vuajtësit, robërit dhe për shpëtimin e tyre, le t'i lutemi Zotit.
- Psaltët:** Mëshiro, o Zot.
- Dhiaku:** Që të shpëtojmë prej çdo hidhërimi, zemërimi, rreziku dhe nevoje, le t'i lutemi Zotit.
- Psaltët:** Mëshiro, o Zot.

Dhiaku: Përkrana, shpëtona, mëshirona dhe ruajna, o Perëndi, me hirin tënd.

Psaltët: Mëshiro, o Zot.

Dhiaku: Të tërëshenjtën, të pacënuarën, të përmbibekuarën, të lavdëruarën Zonjën tonë Hyjlindëse dhe gjithmonë Virgjëren Mari, bashkë me gjithë shenjtoret, duke e kujtuar, veten tonë dhe njeri-tjetrin dhe gjithë jetën tonë, Krishtit Perëndisë, le t'ia parashtrojmë.

Psaltët: Ty, o Zot.

Urata e Andifonit të parë

Prifti: *(pa zë)* O Zot, Perëndia ynë, pushteti i të cilit s'mund të merret me mend, dhe lavdia është e pakuptueshme, përdëllimi i të cilit është i pakufishëm dhe njeridashja e patreguar; Ti o Zot, sipas dhembshurisë sate hidh syrin tënd mbi ne dhe mbi këtë shtëpi të shenjtë, dhe dërgo mbi ne dhe mbi ata që falen bashkë me ne, përdëllimet dhe dhembshuritë e Tua të pasura.

(me zë të lartë) Se Ty të përket tërë lavdia, nderimi dhe adhurimi, Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve.

Psaltët: Amin.

Dhe menjëherë psalin Andifonin e parë:

Psaltët: Me ndërmjetimet e Hyjlindëses, Shpëtimtar shpëtona *(tri herë)*.

Ose në vënd të kësaj thuhet psalmi 102. Kur këndohet Andifoni i parë dhiaku qëndron përpara ikonës së Krishtit.

Pasi mbarohet Andifoni i parë, dhiaku vjen përsëri përpara Derës së Bukur dhe pasi falet thotë:

Dhiaku: Përsëri dhe përsëri me paqe, le t'i lutemi Zotit.

Psaltët: Mëshiro, o Zot.

Dhiaku: Përkrahna, shpëtona, mëshirona dhe ruajna, o Perëndi, me hirin tënd.

Psaltët: Mëshiro, o Zot.

Dhiaku: Të Tërëshenjtën, të pacënuarën, të përmbibekuarën, të lavdëruarën Zonjën tonë Hylindëse dhe gjithmonë Virgjë-rën Mari, bashkë me gjithë shenjtoret, duke e kujtuar, veten tonë dhe njeri-tjetrin dhe gjithë jetën tonë, Krishtit Perëndisë le t'ia parashtrojmë.

Psaltët: Ty, o Zot.

Urata e Andifonit të dytë:

Prifti: *(pa zë)* O Zot Perëndia ynë, shpëto popullin tënd dhe beko trashëgimin tënd; tërë besimtarët e kishës sate ruaji; shenjtëroji ata që duan hijeshinë e shtëpisë sate. Edhe Ti lavdëroji me fuqinë tënde të perëndishme dhe mos na ler ne që shpresojmë tek Ti.

(me zë të lartë) Se yti është pushteti dhe jotja është mbretë-ria, dhe fuqia, dhe lavdia e Atit e Birit dhe e Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve.

Psaltët: Amin.

Dhe menjëherë psalin Andifonin e dytë:

Psaltët: Shpëtona, o i Bir i Perëndisë, që u ngjalle prej së vdeku-rish, ne që të psalim Aliluia *(tri herë)*.

Kur është e kremte, ose në ditët e tjera brenda javës, në vend: «që u ngjalle prej së vdekurish» *thuhet:* «o i çuditshëm ndër shenjtoret».

Psaltët: Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë; tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

O i vetëmlindur Bir dhe Fjalë e Perëndisë, që je i pavdekshëm, dhe dënjove për shpëtimin tonë të trupëzohesh prej Hyjlindëses së shenjtë dhe gjithmonë Virgjërës Mari, duke u bërë njeri pa ndryshuar; që u kryqëzove, o Krisht Perëndi, dhe shkele vdekjen me vdekje, që je një prej Trinisë së Shenjtë dhe lavdërohesh bashkë me Atin dhe me Shpirtin e Shenjtë, shpëtona.

Osë në vënd të kësaj thuhet psalmi 145. Kur këndohet Andifoni i dytë dhiaku qëndron përpara ikonës së Hyjlindëses.

Pasi mbarohet Andifoni i dytë dhiaku vjen përsëri përpara Derës së Bukur, falet dhe thotë:

Dhiaku: Përsëri dhe përsëri me paqe le t'i lutemi Zotit.

Psaltët: Mëshiro, o Zot.

Dhiaku: Përkrahna, shpëtona, mëshirona dhe ruajna, o Perëndi, me hirin tënd.

Psaltët: Mëshiro, o Zot.

Dhiaku: Të Tërshenjtën, të pacënuarën, të përmbibekuarën, të lavdëruarën Zonjën tonë Hyjlindëse dhe gjithmonë Virgjërën Mari, bashkë me gjithë shenjtorët, duke e kujtuar, veten tonë dhe njeri-tjetrin dhe gjithë jetën tonë, Krishtit Perëndisë, le t'ia parashtrojmë.

Psaltët: Ty, o Zot.

Urata e Andifonit të tretë:

Prifti: *(pa zë)* Ti që na fale këto lutje, të cilat i bëjmë dhe i themi së bashku, dhe që premtove t'u japësh ç'të kërkojnë të bashkuarve në emrin tënd, qofshin këta edhe vetëm dy ose tre, Ti dhe tani plotësoi kërkesat e shërbëtorëve në dobi të tyre, duke na falur në këtë botë njohjen e së vërtetës sate dhe duke na dhuruar në botën tjetër jetë të amëshuar.

(me zë të lartë) Se ti je Perëndi mëshirues dhe njeridashës dhe Ty ta drejtojmë lavdinë, Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve.

Psaltët: Amin.

Dhe menjëherë psaltit përlëshoren e tingullit ose të shenjtit. Ose në vend të këtyre psalen Lumturimet simbas tingullit të javës.

Në këtë kohë dhiaku hyn në Hierore.

Mbas uratës së Andifonit të tretë prifti merr Ungjillin, ia jep dhiakut dhe të dy së bashku shkojnë nga ana e djathtë duke pasur përpara dy fëmijë me llambadhe të ndezura, pas tyre dhiaku me Ungjillin, pas këtij prifti dhe kështu bëjnë hyrjen e vogël sipas rregullit. Kur arrijnë në mes të kishës ulin të dy kryet dhe ndërsa dhiaku thotë pa zë: Le t'i lutemi Zotit. Mëshiro, o Zot.

Urata e Hyrjes:

Prifti: *(pa zë)* O Zot Perëndia ynë, Ti që vendose në qiejt legjione dhe armata engjëjsh dhe kryeengjëjsh për t'i shërbyer lavdisë sate, bëj që bashkë me hyrjen tonë, të hyjnë dhe engjëj të shenjtë, që të meshojnë bashkë me ne dhe të lavdërojnë bashkë me ne mirësinë tënde. Se ty të përket tërë lavdia, nderimi dhe adhurimi, Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve.

Pas mbarimit të uratës, dhiaku duke mbajtur Orarin me tre gishtat e dorës së djathtë dhe duke treguar nga lindja, i thotë priftit me zë të ulët:

Dhiaku: Beko, o Zot, hyrjen e shenjtë.

Dhe prifti duke bekuar thotë:

Prifti: E bekuar është hyrja në shenjtëroren tënde, o Zot, gjithnjë; tani e përherë e në jetë të jetëve.

Pastaj dhiaku shkon tek episkopi, i cili puth Ungjillin, në mungesë të tij e puth prifti. Si mbarohet përlëshorja, dhiaku qëndron përpara priftit dhe duke ngritur pak Ungjillin lart, thotë me zë të lartë:

Dhiaku: Urtësi. Drejt.

Dhiaku hyn në altar dhe vë Ungjillin e shenjtë mbi Tryezën e shenjtë dhe prifti, duke u përkulur pak nga ana e fronit episkopal në shenjë nderimi, hyn dhe ky në altar, ndërsa psaltët thonë:

Psaltët: Ejani t'i falemi e t'i biem ndër këmbë Krishtit. Shpëtona, o Bir i Perëndisë, që u ngjalle prej së vdekurish, ne që të psalim: Alilluia.

Në qoftë se meshon episkop ose më shumë se një prift «Ejani ti falemi...» psalet prej tyre në mes të Kishës, ndërsa psalti i majtë përsërit edhe një herë «Shpëtona...». Pastaj psalen përlëshorja ngjallësore e tingullit, Tropari i shenjtit të kishës dhe i shenjtit të ditës dhe kondaqi i këtij, po të ketë; po të mos ketë thuhet kondaqi i të kremteve të mëdha (të ngritjes së Kryqit, të hyrjes së Shën Marisë në kishë, të Krishtlindjes, të Ujit të Bekuar, të Ipapandisë, të Ungjillëzimit, të Pashkës, të Ngritjes në qiell, të Shpërfytyrimit, të Fjetjes së Hyjlindëses), ndërsa në të dielat e tjera kondaqi i mëposhtëm:

Psaltët: Mbrojtje e paturpëruar e të krishterëve, ndërmjetim i pandërprerë ndaj krijuesit, dëgjo zërat e lutjeve të mëkatarëve dhe arri si e mirë për të na ndihmuar ne që të thërresim me besë: nxito të ndërmjetosh dhe shpejto të lutesh, o Hyjlindëse që mbron ngaherë ata që të nderojnë.

Dhiaku: Le t'i lutemi Zotit.

Psaltët: Mëshiro, o Zot.

Prifti: *(pa zë)* O Perëndi i shenjtë, që prehesh ndër të shenjtët, që himnosh me zë trishenjtor nga serafimet dhe që lavdërosh nga keruvimet e që adhurosh nga çdo fuqi qie-

llore, ti që krijove gjithësinë nga e mosqena; që bërë njeriun simbas ikonës dhe shembëllesës sate, dhe e stolise me tërë dhuratat e tua; ti që i jep urtësi dhe mençuri atij që kërkon, dhe nuk e heq syrin nga mëkatari, por caktove pendimin për shpëtim, ti që na bërë të denjë ne shëbëtorët e tu të përlurur dhe të padenjë që të qëndrojmë në këtë orë përpara lavdisë të altarit tënd të shenjtë dhe të të parashtrojmë adhurimin dhe lavdërimin që kemi për detyrë ndaj Teje; Ti, o Zot, prano dhe nga goja e ne mëkatarëve himnin trishenjtor, dhe vështrova me mirësinë tënde. Falna çdo faj të bërë me dashje ose pa dashje, shenjtërona shpirtat dhe trupat tanë dhe bëna të denjë që të të adhurojmë me shpresëtarë tërë ditët e jetës sonë; me ndërmjetimet e Hyjlindëses së shenjtë dhe të gjithë shenjtorëve që të kanë pëlqyer që prej jete.

(me zë të lartë) Se i shenjtë je, o Perëndia ynë dhe Ty ta drejtojmë lavdinë, Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë,

Dhiaku: e në jetë të jetëve.

Psaltët: Amin.

Dhe menjëherë psalin:

Shenjt Perëndi, Shenjt i fuqishëm, Shenjt i pavdekshëm, mëshirona **(tri herë)**.

Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë.

Tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Shenjt i pavdekshëm, mëshirona.

Dhiaku: Fuqi.

Psaltët: Shenjt Perëndi, Shenjt i fuqishëm, Shenjt i pavdekshëm, mëshirona.

Si mbaron uratën, prifti dhe dhiaku thonë: «Shenjt Perëndi...» pa zë tri herë duke bërë tri metanira. Kur meshon episkop

dhe kur meshojnë më shumë se një prift, «Shenjt Perëndi...» e psalin dhe këta nga Hierorja. Pastaj dhiaku i thotë priftit, pa zë:

Dhiaku: Urdhëro, o Zot.

Prifti bekon duke thënë:

Prifti: I bekuar është ai që vjen në emrin e Zotit.

Dhiaku: Beko, o Zot, fronin lart.

Prifti: I bekuar je mbi fronin e lavdisë së mbretërisë sate, ti që rri mbi Keruvimet, gjithnjë; tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Të Dielën e Faljes së Kryqit (e diela e tretë e kreshmëve) në vend të «Shenjt Perëndi...» psalet himni «Kryqit tënd i falemi, o Zot, dhe Ngjalljen tënde të shenjtë e lavdërojmë.» Në të kremtet e mëdha të Krishtlindjes, të Ujit të Bekuar, në vend të «Shenjt Perëndi...» psalet: «Sa u pagëzuat me Krishtin, me Krishtin u veshet. Aliluia.»

Pas mbarimit të «Shenjt Perëndi...» dhiaku del te Dera e Bukur.

Lexuesi

(Anagnosti): *(thotë vargun e parë të Apostullit).*

Dhiaku: Le të vemë re!

Lexuesi

(Anagnosti): *(thotë vargun e dytë të Apostullit).*

Dhiaku: Urtësi!

Lexuesi

(Anagnosti): Këndimi nga letra e...

Dhiaku: Le të vemë re!

Lexuesi (Anagnosti) vazhdon Apostullin.

Dhiaku merr temjanicën dhe me zë të ulët i thotë priftit:

Beko, o Zot, temjamin.

Prifti e bekon atë, duke thënë me zë të ulët uratën e Temjamit.

I bekuar është Perëndia ynë gjithnjë; tani e përherë, e ne jetë të jetëve. Amin.

Temjamë po të blatojmë, o Krishti Perëndi, si e erë kundërmini shpirtëror, të cilën pasi ta pranosh në alltarin tënd permbiqiellor, dërgona si shpërblim hirin e Shpirtit tënd të tërëshënjtë.

Dhiaku temjanis rreth Tryezës së Shenjtë, Proskomidhinë e shenjtë; dhe nga Dera e Bukur temjanis ikonat dhespotike, fronin arkieratik edhe popullin. Kthehet në Hierore, temjanis Tryezën e Shënjtë, priftin dhe gjithë priftërinjtë.

Dhiaku: *(me zë të ulët)* Le ti lutemi Zotit. Mëshiro, o Zot.

Urata para Ungjillit:

Prifti: *(pa zë)* O Zot njeridashës, bëj që të shkëlqejë në zemrat tona drita e kulluar e njohjes së hyjnisë sate, dhe çil sytë e mendjes sonë për të kuptuar mësimet e tua ungjillore. Futna dhe frikën e porosive të tua të lumtura, që, pasi të shtypim të gjitha epshet trupore, të mundim të kalojmë një jetë shpirtërore, duke menduar dhe duke bërë të gjitha ato që të pëlqejnë. Se ti je ndriçimi i shpirtave dhe i trupave tanë, o Krisht Perëndi, dhe ty ta drejtojmë lavdinë, bashkë me Atin tënd pa fillim dhe Shpirtin tënd të tërëshënjtë, të mirë dhe jetëbërës, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Dhiaku pas temjanisjes, ve temjanicën në vendin e saj, i afrohet priftit, ul kryet dhe duke mbajtur me tre gishta Orarin së bashku me Ungjillin, thotë:

Dhiaku: Beko, o Zot, lexuesin e Ungjillit të Apostullit të shenjtë, të lavdëruar dhe Ungjillorit *(aksh)*.

Prifti e bekon duke bërë shenjën e Kryqit mbi krye dhe thotë:

Prifti: Perëndia, me ndërmjetimet e Apostullit të shenjtë, të lavdëruar dhe Ungjillor (*aksh*), të dhëntë ty, lexuesit, fuqi të shumtë, për të plotësuar veprën e Ungjillit, të Birit të tij të dashur dhe Zotit tonë Iisu Krisht.

Dhiaku: Amin. Amin. Amin. U bëftë tek unë sipas fjales sate.

Dhe duke iu falur Ungjillit të shenjtë me shpresëtari, e merr atë nga duart e priftit, i puth dorën edhe thotë:

O Apostuli i shenjtë, dhe Ungjillor (...), ndërmjeto tek Perëndia mëshirëplotë që t'u japë ndjesë fajesh spirtrave tanë.

Pasi mbarohet këndimi i Apostullit, lexuesi vjen përpara Derës së Bukur dhe puth dorën e priftit, i cili duke e bekuar thotë:

Prifti: Paqe mbi ty që këndon dhe mbi gjithë popullin.

Psaltët: Aliluia (*tri herë*).

Dhiaku ngrihet dhe me Ungjillin del nga dera e veriut duke patur përpara dy djem me llambadhe të ndezura dhe shkon në amvon ose në fronin e episkopit në qoftë se kisha nuk ka amvon. Prifti vjen te Dera e Bukur dhe thotë:

Prifti: (*me zë të lartë*) Urtësi. Drejt. Le të dëgjojmë Ungjillin e shenjtë. Paqe në të gjithë.

Psaltët: Dhe në shpirtin tënd.

Dhiaku: Këndimi prej Ungjillit të Shenjtë sipas...

Prifti: Le të vemë re.

Psaltët: Lavdi me Ty, o Zot, lavdi me Ty.

Dhiaku këndon Ungjillin e ditës. Kur mbaron këndimi i Ungjillit, prifti bekon dhe thotë:

Prifti: Paqe më ty që lexon Ungjillin.

Psaltët: Lavdi me Ty, o Zot, lavdi me Ty.

Dhiaku zbret nga amvona. Vjen përpara Derës së Bukur dhe i jep Ungjillin e shenjtë priftit, i cili e vendos në Tryezën e shenjtë mbi Andimins.

Dhiaku qëndron në vendin e zakonshëm dhe thotë:

Dhiaku: Le të themi të gjithë, me tërë shpirtin dhe me tërë mendjen tonë, le të themi.

Psaltët: Mëshiro, o Zot (*tri herë*).

Dhiaku: O Zot, i gjithëpushtetshëm, Perëndia i etërve tanë, të lutemi dëgjo e mëshiro.

Psaltët: Mëshiro, o Zot (*tri herë*).

Dhiaku: Mëshirona, o Perëndi, sipas mëshirës sate së madhe, të lutemi, dëgjo e mëshiro.

Psaltët: Mëshiro, o Zot (*tri herë*).

Në kohën që dhiaku thotë lutjen e gjatë (ektenis), prifti thotë pa zë këtë uratë:

Prifti: (*pa zë*) O Zot Perëndia ynë, prano këtë lutje të gjërë prej shërbëtorëve të tu dhe mëshirona sipas mëshirës sate të shumtë; dhe dërgo dhembshuritë e tua mbi ne dhe mbi gjithë popullin tënd që pret prej teje mëshirën e pasur.

Dhiaku: Lutemi dhe për Kryepiskopin (*ose* episkopin) tonë (*aksh*)

Psaltët: Mëshiro, o Zot (*tri herë*).

Dhiaku: Lutemi dhe për vëllezërit tanë: priftërinjtë, ieromonakët, ierodhiakonët, monakët dhe për tërë vëllazërinë tonë më Krishtin.

Psaltët: Mëshiro, o Zot (*tri herë*).

Dhiaku: Lutemi edhe për mëshirë, jetë, paqe, shëndet, shpëtim, vështrim, ndjesë dhe falje të mëkateve të shërbëtorëve të Perëndisë, gjithë të krishterëve shpresëtarë dhe orthodhoksë, që banojnë dhe ndodhen në këtë qytet (*ose* manastir).

Psaltët: Mëshiro, o Zot (*tri herë*).

Dhiaku: Lutemi dhe për të lumturit dhe gjithmonëkujtueshmit themelues të kësaj shtëpie të shenjtë, dhe për tërë etërit dhe vëllezërit tanë të parafjetur, orthodhoksë që prehen me shpresë këtu e kudo.

Psaltët: Mëshiro, o Zot (*tri herë*).

Dhiaku: Lutemi dhe për ata që sjellin pemë dhe bëjnë punë të mira në këtë kishë të shenjtë dhe të gjithënderuar, që mundohen, që psalin dhe për popullin që qëndron rrotull, dhe pret prej Teje mëshirën e madhe dhe të pasur.

Psaltët: Mëshiro, o Zot.

Prifti: (*me zë të lartë*) Se ti je Perëndi mëshirues dhe njeridashës dhe ty ta drejtojmë lavdinë, Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve.

Psaltët: Amin.

Në këtë kohë prifti merr Ungjillin e shenjtë dhe bën shenjën e Kryqit mbi Andiminsin e shenjtë.

Dhiaku: Lutjuni Zotit ju katikumenët.
Ne besimtarët le të lutemi për katikumenët.
Që t'i mëshirojë Zoti,
Që t'u mësojë fjalën e së vërtetës,
Që t'u zbulojë ungjillin e drejtësisë,
Që t'i bashkojë me Kishën e shenjtë, të përgjithshme dhe apostolike.
Shpëtoi, mëshiroi, përkrahi dhe ruaji, o Perëndi, me hirin tënd.

Psaltët: Mëshiro, o Zot.

Dhiaku: Ju katikumenë, kryet tuaj uljani Zotit.

Urata e katikumenëve, të cilën prifti e thotë përpara se të hapet Andiminsi:

Prifti: *(pa zë)* O Zot, Perëndia ynë, që banon në qiejt dhe kqyr gjithë veprat e tua, shtjer sytë mbi shërbëtorët e Tu, katikumenët, që kanë ulur kryet përpara Teje; dhe jepu atyre zgjedhën e lehtë; bëji ata anëtarë të çmuar të Kishës sate të shenjtë dhe tregoi të denjë për banjën e rilindjes, për ndjesën e mëkateve dhe për rroben e mosprishjes që të të njohin Ty Perëndinë tonë të vërtetë.

(me zë të lartë) Që dhe ata bashkë me ne të lavdërojnë emrin tënd të gjithënderuar dhe madhështor, të Atit, të Birit dhe të Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve.

Në këtë kohë prifti hap Andiminsin dhe bën mbi të shënjën e Kryqit.

Psaltët: Amin.

Dhiaku: Sa jeni katikumenë, shkoni, ju katikumenë, shkoni. Asnjë nga katikumenët të mos qëndrojnë. Sa janë besimtarë. Përsëri dhe përsëri me paqe le t'i lutemi Zotit.

Psaltët: Mëshiro, o Zot.

Prifti thotë uratën e parë të besimtarëve pas hapjes së Andiminsit:

Prifti: *(pa zë)* Ti o Zot, na tregove këtë mister të madh të shpëtimit; Ti na bërë të denjë ne, shërbëtorët e Tu të përulur e të padenjë, që të bëhemi meshëtarë të altarit tënd të shenjtë; Ti, me fuqinë e Shpirtit tënd të Shenjtë, bëna të aftë për këtë shërbesë, që, duke qëndruar pa dënim përpara lavdisë sate të shenjtë, të të blatojmë therore lavdërimi; Ti je Ai që i bën të gjitha në të gjithë. Bëj, o Zot, që të jetë e pranueshme dhe e mirëpritur përpara Teje therorja jonë edhe për mëkatet tona edhe për fajet e popullit të bëra nga padija.

Dhiaku: Përkrahna, shpëtona, mëshirona dhe ruajna o Perëndi me hirin tënd. Urtësi.

Prifti: *(me zë të lartë)* Se ty të përket tërë lavdia, nderimi dhe adhurimi, Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve.

Psaltët: Amin.

Dhiaku: Përsëri dhe përsëri me paqe, le t'i lutemi Zotit.

Psaltët: Mëshiro, o Zot.

Prifti thotë uratën e dytë të besimtarëve:

Prifti: *(pa zë)* O Perëndi, që vështrove me përdëllim e dhembshuri përrulësinë tonë, që na vure ne shërbëtorët e Tu të përrulur, mëkatarë e të padenjë, përpara lavdisë sate të shenjtë për të meshuar në altarin tënd të shenjtë; Ti forcona me fuqinë e Shpirtit tënd të Shenjtë për këtë shërbesë; dhe kur të çelim gojën falna fjalë për të thirrur hirin e Shpirtit tënd të Shenjtë, mbi dhurarat që do të blatohen.

Dhiaku: Përkrahna, shpëtona, mëshirona dhe ruajna, o Perëndi, me hirin tënd. Urtësi.

Prifti: *(me zë të lartë)* Që, të ruajtur gjithnjë prej fuqinë sate, të të drejtojmë lavdinë, Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve.

Psaltët: Amin.

Dhe menjëherë këndojnë himnin keruvik:

Psaltët: Ne që simbolizojmë mistikërisht keruvimet, dhe i këndojmë Trinisë jetëbërëse himnin trishenjtor, le të largojmë prej nesh tërë kujdesin për jetën; që mbretin,...

Kur psalet himni keruvik, prifti lexon këtë uratë të himnit keruvik:

Prifti: *(pa zë)* Asnjë nga ata që janë lidhur me epshet dhe dëfrimet trupore nuk është i denjë të vijë tek Ti, ose të të afrohet ose të të shërbejë Ty, o mbret i lavdisë; se të shërbyerit tek Ti është një gjë e madhe dhe e frikshme edhe për

fuqitë qiellore; mirëpo nga njeridashja jote e patreguar dhe e pamatur u bëre njeri pa u ndryshuar, dhe ke qenë kryepriifti ynë, dhe si Zot i gjithësisë na dorëzove shërbesën e shenjtë të kësaj meshe dhe theroreje të pagjakshme; se vetëm Ti, o Zot Perëndia ynë i sundon qielloret dhe të dheshmet, Ti që rri mbi fronin keruvik, Zoti i serafimeve dhe mbret i Izraelit, që je i vetmi shenjt dhe që prehesh ndër shenjtoret. Të lutem pra, Ty të vetmit të mirë dhe të gatshëm për të dëgjuar, shtjer sytë mbi mua shërbëtorin tënd mëkatar dhe të padobishëm, dhe pastroma shpirtin dhe zemrën nga ndërgegja e keqe, dhe bëmë të zotin me fuqinë e Shpirtit tënd të Shenjtë, mua që kam veshur hirin e priiftërisë, të qëndroj përpara kësaj tryezës tënde të shenjtë, dhe t'i shërbej flijimit të Trupit tënd të shenjtë e të pacënuar dhe Gjakut tënd të nderuar. Se tek Ti vij duke ulur kryet dhe Ty të lutem; mos e hiq fytyrën tënde nga unë, as mos më përjashto nga rrethi i shërbëtorëve të tu, po denjo të të blatohen këto dhurata prej meje, shërbëtorit tënd mëkatar dhe të padenjë. Se Ti je blatuari dhe i blatuari, Ai që pranon dhe që jep vetveten, o Krisht Perëndia ynë dhe Ty ta drejtojmë lavdinë, bashkë me Atin tënd pa fillim dhe me Shpirtin tënd të tërëshenjtë, të mirë dhe jetëbërës, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Pasi mbaron uratën e himnit keruvik, priifti thotë pa zë tri herë himnin keruvik «Ne që simbolizojmë...» deri «tërë kujdesin për jetën».

Dhiaku e plotëson duke thënë:

Që mbretin e të gjithave të presim, të pasuar padukurisht prej rreshtave engjëllore. Alilua, Alilua, Alilua.

Të Enjten e Madhe e të shëntë, në vend të «Ne që simbolizojmë», priifti thotë troparin (që këndohet edhe nga psaltët, sipas T.T.II-te):

Prifti: Ne Darkën tënde mistike, o Bir i Perëndisë, merrmë sot pjesëtar, se nuk do t'ua them armiqve të tu misterin; nuk do të të jap të puthur si Judha,

Dhiakoni shton: por, duke të pohuar si kusari thërres: kujtomë, o Zot, kur të vish në mbretërinë tënde.

Ky tropar këndohet prej psaltëve edhe ne vend të Qinonikos.

Kurse të Shtunën e Madhe thuhet prej priftit tropari i mëposhtëm (që këndohet edhe prej psaltit sipas T.T.I):

Prifti: Le të heshtë çdo trup njerëzor dhe le të qëndrojë më frikë e tmerr e le të mos mendojë me vete asgjë të dheshme; se mbreti i mbretërve dhe Zoti i zotëruesve vjen që të theret dhe të jëpet për të ngrënë në besimtarët; dhe përpara i shkojnë koret e Engjejve me çdo kryesi e pushtet;

Dhe dhiaku shton:

Heruvimet e shumsyshmë dhe Serafimet gjashtëkrahës, duke mbuluar fytyrat e duke thirrur himnin: Aliluia, aliluia, aliluia.

Prifti merr temjanicën, i bekon duke thënë:

I bekuar është Perëndia ynë gjithnjë; tani e përherë, e ne jetë të jetëve. Amin.

Temjanë po të blatojmë, o Krisht Perëndi, si e erë kundërmimi shpirtëror, të cilën pasi ta pranosh në alltarin tënd përmbiqiellor, dërgona si shpërblim hirin e Shpirtit tënd të tërëshënjtë.

Pastaj prifti temjanis Tryezën e shenjtë, ikonat dhe popullin duke thënë pa zë, në qoftë se është e diel: «Ne që pamë ngjalljen e Krishtit...» «Ejani të falemi...» dhe pastaj psalmin 50. Kur arrin te vargu «Atëherë do të të pëlqejë therore drejtësisë...» hyn brenda në Hierore, temjanis Tryezën e shenjtë, Proskomidhinë dhe të gjithë sa janë brenda dhe si ve temjanicën në vendin e saj. Dhiaku merr temjanicën e temjanis priftin dhe të tjerët. Pastaj prifti së bashku me dhiakun qëndrojnë përpara Tryezës së shenjtë.

Dhe si falen që të dy tri herë, puthin Andiminsin e shenjtë dhe Tryezën e shenjtë, duke thenë secili:

Mëkatova përpara Teje, o Shpëtimtar, si bir i shturur, pranomë të penduar, o Atë, dhe mëshiromë, o Perëndi.

Të thërres, o Krisht Shpëtimtar, me zërin e doganierit, falmë si atë, dhe mëshiromë, o Perëndi.

Pastaj, secili duke u përkulur para bashkëmeshtarëve të tjerë apo dhe klerikëve të tjerë që ndodhen në altar thotë:

Falmëni, o vëllezër dhe bashkëmeshëtarë, ose Falmë, o vëlla dhe bashkëmeshëtar.

Pastaj kthehet nga populli dhe duke kërkuar ndjesë me përkulje thotë:

O Perëndi, fali ata që na urrejnë e na duan.

Dhe duke bekuar popullin, prifti shkon në Proskomidhinë e hirshme. Atje ul kryet dhe duke u falur tri herë, thotë në çdo falje:

O Perëndi, falmë mua mëkatarin dhe mëshiromë.

Dhiaku i thotë priftit:

Ngreji, o Zot.

Prifti merr Mbulesën e madhe (Ajrin), e vë mbi supet e dhiakut, duke thënë:

Me paqe ngreni duart tuaja në të shenjtat dhe bekoni Zotin.

Pastaj prifti merr Dhiskun e shenjtë të mbuluar dhe ia vendos me vëmendje dhe shpresëtarë dhiakut mbi kryet. Merr dhe prifti Potirin e shenjtë, gjithashtu të mbuluar, duke thënë:

U ngjit Perëndia me brohoritje, Zoti me zë trumbete.

Kur psaltët kanë mbaruar së kënduari «Që mbretin...», prifti dhe dhiaku dalin nga dera veriore për Hyrjen e Madhe; përpara shkojnë femijë më Kryqin, Gjashtëkrahëshe, me llambada të ndezura dhe temjanicë. Duke shkuar drejt mesit të kishës, dhiaku thotë:

Dhiaku: *(me zë të lartë)* Të gjithë ne edhe të gjithë të krishterët shpresëtarë dhe orthodhoksë na kujtoftë Zoti Perëndia në mbretërinë e Tij, gjithnjë, tani e përherë e në jetë të jetëve.

Psaltët: Amin.

Kur vijnë përpara Derës së Bukur, Dhiaku hyn në Hierore dhe qëndron në të djathtë të Tryezës së shenjtë, duke pritur priftin.

Prifti kur arrin në mes të Kishës thotë me zë të lartë:

Kryepiskopin ose episkopin tonë (*aksh*), dhe gjithë vëllazërinë tonë më Krishtin. Kombin tonë shpresëtar, udhëheqjen dhe ushtrinë et tij. Te gjithë ata që banojnë e ndodhen në këtë qytet (*a* vend); enoritët, epitropët, ndihmëtarët, dhuruesit e kësaj kishe të shenjtë si edhe të gjithë ne që marrim pjesë në këtë meshë hyjnore.

Ndërtuesit e lumtur e të gjithmonëkujtueshëm, rindërtuesit dhe dhuruesit e kësaj kishe të shenjtë, ata që ranë për fenë e për atdhenë dhe të gjithë etërit dhe vëllezërit tanë që kanë ndërruar jetë me shpresë ngjalljeje dhe jetë të pasosur, i kujtoftë Zoti Perëndia në mbretërinë e Tij, gjithnjë, tani e përherë e në jetë të jetëve.

Psaltët: Amin.

Prifti hyn në Hierore, vendos Potirin e shenjtë mbi Andiminsin, mbi Tryezën e shenjtë, nga krahu i djathtë. Prifti, duke marrë temjanicën nga duart e shërbyesit, temjanis dhiakun i cili mban Dhiskun e shenjtë mbi kryet.

Psaltët menjëherë përfundojnë himnin Keruvik:

Psaltët: ... e të gjithave të presim, të pasuar padukurisht prej rreshtave engjëjlore. Aliluia, Aliluia, Aliluia.

Kur merr pjesë në meshë episkop apo kryepiskop, nuk del në hyrjen e madhe por qëndron përpara Derës së Bukur pa mitër dhe pret dhuratat e çmuara, ndërsa dhiaku dhe prifti duke i dorëzuar me radhë, i pari Dhiskun dhe i dyti Potirin, thonë:

Kryepriftërinë tënde, e kujtoftë Zoti Perëndia në mbretërinë e tij, gjithnjë; tani e përherë e në jetë të jetëve.

Dhiaku i thotë priftit ose Kryepiskopit apo episkopit: rinë tënde (ose Kryepriftërinë tënde) e kujtoftë Zoti Perëndia në mbretërinë e tij, gjithnjë, tani e përherë e në jetë të jetëve». *Prifti ose Kryepiskopi apo episkopi thotë:* «Diakoninë tënde e kujtoftë...». *Pastaj prifti merr Dhiskun e shenjtë nga kryet e Dhiakut, e uth atë dhe e vendos mbi Andiminsin, mbi Tryezën e shenjtë, pranë Potiri të shenjtë nga krahu i majtë, duke thenë:*

Bujari Josif, si e zbriti prej drurit trupin tënd të pacënuar, e mbështolli me pëlhurë të pastër dhe me aroma dhe e varrosi, të paprekshëm nga prishja.

Prifti zbulon Dhuratat, merr Mbulesen e madhe (Ajrin) nga supet e dhiakut, e temjanis dhe mbulon Potirin dhe Dhiskun së bashku dhe i uth ato.

Dhiaku: Bëje të mirë, o Zot.

Prifti merr temjanicën dhe temjanis të Shenjtat duke thënë: «Atëherë do të sjellin viça mbi altarin tënd, dhe mëshiromë, o Perëndi».

Pastaj prifti, si ia jep temjanicën dhiakut, i cili e vë në vend, dhe duke ulur kryet, i thotë dhiakut:

Kujtomë, o vëlla dhe bashkëmëshëtar.

Dhiaku: Priftërinë tënde e kujtoftë Zoti Perëndia në mbretërinë e tij gjithnjë; tani e përherë e në jetë të jetëve.

Pastaj dhiaku ul kryet përpara priftit duke mbajtur Orarin me dorën e djathë dhe thotë:

Dhiaku: Lutu për mua, o Zot i shenjtë.

Prifti: Shpirti i Shenjtë do të vijë mbi ty dhe fuqia e të Lartit do të të mbrojë.

Dhiaku: Shpirti vetë do të meshojë bashkë me ne tërë ditët e jetës sonë.

Kujtomë, o Zot i shenjtë.

Prifti: Diakoninë tënde të kujtoftë Zoti Perëndia në mbretërinë e tij, gjithnjë; tani e përherë e në jetë të jetëve.

Dhiaku: Amin.

Dhiaku si puth dorën e djathtë të priftit, del nga Hierorja dhe qëndron në vendin e zakonshëm dhe thotë:

Dhiaku: Le ta plotësojmë lutjen tonë ndaj Zotit.

Psaltët: Mëshiro, o Zot.

Dhiaku: Për Dhuratat e çmuara të paravëna, le t'i lutemi Zotit.

Psaltët: Mëshiro, o Zot.

Dhiaku: Për këtë shtëpi të shenjtë dhe për ata që hyjnë brenda në të me besë, shpresëtari dhe frikë Perëndie, le t'i lutemi Zotit.

Psaltët: Mëshiro, o Zot.

Dhiaku: Që të shpëtojmë prej çdo hidhërimi, zemërimi, rreziku dhe nevoje, le t'i lutemi Zotit.

Psaltët: Mëshiro, o Zot.

Ndërsa dhiaku vazhdon paqësoret, prifti thotë uratën e Proskomidhisë:

Prifti: *(pa zë)* O Zot Perëndia ynë, që na krijove e na solle në këtë jetë, që na tregove rrugët për shpëtim, që na zbulove

misteret qiellore; Ti je ai që na caktove në këtë shërbesë me fuqinë Shpirtit tënd të Shenjtë. Dënjo pra, o Zot, që të bëhemi shërbëtorë të Dhiatës sate së Re, meshëtarë të Mistereve të Tua të shenjta; pranona, sipas përdëllimit tënd të shumtë, ne që po i afrohemi altarit Tënd të shenjtë; që të bëhemi të denjë të të blatojmë ketë theror, shpirtëror dhe të pagjakshëm për mëkatet tona edhe padijat e popullit; të cilin duke e pranuar në altarin tënd të shenjtë përmbiqiellor, dhe të kuptuar me anën e mendjes, si aromë shpirtërore, dërgona si shpërblim hirin e Shpirtit tënd të Shenjtë. Shtjer sytë mbi ne, o Perëndi, dhe vështro mbi këtë adhurimin tonë dhe pranoje këtë, sikurse pranove dhuratat e Avelit, theroret e Noes, theroret me djegie të plotë të Avraamit, shërbesat priftërore të Moisiut dhe të Aaronit dhe dhuratat paqësore të Samuelit; sikurse pranove prej Apostujve të Tu të shenjtë këtë adhurim të vërtetë, ashtu o Zot, prano këto dhurata prej duarve tona mëkatare, sipas mirësisë sate; që, pasi të bëhemi të denjë të meshojmë pa gabim në altarin tënd të shenjtë, të marrim pagën e kujdestarëve besnikë e të mençur në ditën e tmerrshme të shpërblimit tënd të drejtë.

Dhiaku vazhdon:

- Dhiaku:** Përkrahna, shpëtona, mëshirona dhe ruajna, o Perëndi, me hirin tënd.
- Psaltët:** Mëshiro, o Zot.
- Dhiaku:** Ditën të tërë, të përsosur, të shenjtë, me paqe dhe të pamëkatshme, le t'ia lypim Zotit.
- Psaltët:** Falna, o Zot.
- Dhiaku:** Engjëll paqeje, udhëheqës besnik, ruajtës të shpitrave dhe të trupave tanë, le t'ia lypim Zotit.
- Psaltët:** Falna, o Zot.
- Dhiaku:** Ndjesë dhe falje të mëkateve dhe të fajeve tona, le t'ia lypim Zotit.

- Psaltët:** Falna, o Zot.
- Dhiaku:** Të mirat dhe të dobishmet për shpirtrat tanë dhe paqe për botën, le t'i lypim Zotit.
- Psaltët:** Falna, o Zot.
- Dhiaku:** Që të kalojmë në paqe dhe në pendim jetën që na mbetet, le t'i lypim Zotit.
- Psaltët:** Falna, o Zot.
- Dhiaku:** Mbarim të krishterë të jetës sonë, pa dhembje, faqebardhë, me paqe, dhe mbrojtje të mirë përpara gjykatores së trembshme të Krishtit, le të lypim.
- Psaltët:** Falna, o Zot.
- Dhiaku:** Të Tërëshenjtën, të pacënuarën, të përmbibekuarën, të lavdëruarën Zonjën tonë, Hyjlindëse dhe gjithmonë Virgjërën Mari, bashkë me gjithë shenjtorët, duke e kujtuar, veten tonë dhe njeri-tjetrin dhe gjithë jetën tonë. Krishtit Perëndisë, le t'ia parashtrojmë.
- Psaltët:** Ty, o Zot.
- Prifti:** *(me zë të lartë)* Me përdëllimet e Birit tënd të vetëmlindur, me të cilin je i bekuar bashkë me Shpirtin tënd të tërëshenjtë, të mirë dhe jetëbërës, tani e përherë e në jetë të jetëve.
- Psaltët:** Amin.
- Prifti:** Paqe në të gjithë.
- Psaltët:** Dhe në shpirtin tënd.
- Dhiaku:** Le të duam njeri-tjetrin që të rrëfejmë me një mendje.
- Psaltët:** Atin e Birin edhe Shpirtin e Shenjtë, Trininë e njëqenshme e të pandarë.

Në këtë kohë prifti duke u falur tri herë thotë dhe ai pa zë:
 «Do të të dua, o Zot, fuqia ime, Zoti është mbështetja ime, streha ime dhe shpëtimtari im».

Pastaj puth Dhuratat e shenjta siç janë të mbuluara, së pari Dhiskun pastaj Potirin dhe kryqin mbi Andiminsin dhe anën e Tryezës së shenjtë. Kur meshojnë më shumë priftërinj se një, puthin të gjithë dhuratat e shenjta me radhë dhe përqafojnë njeri-tjetrin, duke thënë:

Krishti midis nesh.

Edhe ishte, edhe është, dhe do të jetë.

Ndërsa dhiaku që qëndron jashtë ne vendin e zakonshëm, puth kryqin e Orarit. Kur janë më shumë dhiakonë, puthin Orarin e njeri-tjetrin (edhe në sup) duke thënë edhe ata të njejtën gjë. Dhe pas kësaj, dhiaku thotë:

Dhiaku: Dyert! Dyert! me urtësi, le të vëmë re.

Lexuesi: *(me zë):*

I. Besoj në një Perëndi, Atë të tërëfuqishëm, krijues të qiellit dhe të dheut dhe të gjithë të dukurave dhe të padukurave.

II. Dhe në një Zot, Iisu Krishtin, Birin e Perëndisë, të vetëmlindurin, që lindi prej Atit përpara gjithë shekujve. Dritë prej drite, Perëndi të vërtetë prej Perëndie të vërtetë, të lindur, jo të bërë, që ka të qenët një me Atin, me anën e të cilit u bënë të gjitha.

III. Që për ne njerëzit edhe për shpëtimin tonë, zbriti prej qiejve, edhe u trupëzua prej Shpirtit të Shenjtë dhe Virgjëreshës Mari dhe u bë njeri.

IV. Dhe u kryqëzua për ne në kohën e Pontit Pilat, dhe pësoi e u varros.

V. Dhe u ngjall të tretën ditë sipas shkrimeve.

VI. Dhe u ngjit në qiejt dhe rri në të djathtë të Atit.

VII. Dhe do të vijë përsëri me lavdi të gjykojë të gjallët dhe të vdekurit, mbretëria e të cilit nuk do të ketë mbarim.

VIII. Dhe në Shpirtin e Shenjtë, Zot, jetëbërës, që buron prej Atit, që adhurohet e lavdërohet bashkë me Atin e me Birin, që foli me anën e profetëve.

IX. Në një Kishë të shenjtë, të përgjithshme dhe apostolike.

X. Pohoj një pagëzim për ndjesën e mëkateve.

XI. Pres ngjalljen e të vdekurve.

XII. Dhe jetën e ardhshme të amëshuar.

Psaltët: Amin.

Prifti ngre Mbulesën e madhe (Ajrin) dhe e lëviz përmbi Dhuratat e shenjta duke thënë dhe ai Simbolin e besimit. Kur Anagnosti arrin në fjalët: «Dhe u ngjit në qiejt...», ngre Ajrin dhe bën me cepat e tij formën e kryqit mbi Dhuratat e çmuara, e palos, e puth edhe e vendos në anën e djathtë bashkë me Mbulesat e tjera. Po të jenë dhe priftërinj të tjerë që meshojnë, këtë punë e bëjnë bashkërisht duke e kapur mbulesën nga të katër cepat.

Si mbaron Simboli i Besimit dhiaku thotë:

Dhiaku: Le të qëndrojmë mirë, le të qëndrojmë me frikë, le të kemi kujdes, që ta blatojme me paqe theroren e shenjtë.

Psaltët: Mëshirë paqeje, therore lavdërimi.

Prifti duke marrë me tre gjishtërinjtë e dorë së djathtë Ajrin e palosur, e lëviz mbi Potirin e shenjtë dhe Dhiskun e shenjtë; si e vendos, thotë përpara popullit duke bekuar:

Prifti: Hiri i Zotit tonë Iisu Krisht, dhe dashuria e Perëndisë dhe Atit dhe pjesëmarrja e Shpirtit të Shenjtë qoftë me ju të gjithë.

Psaltët: Dhe në shpirtin tënd.

Prifti: Le t'i ngremë lart zemrat *(ngre duart e të lartë)*.

Psaltët: I kemi te Zoti.

Prifti: Le ta falënderojmë Zotin.

Psaltët: I ka hije dhe është e drejtë.

Dhiaku hyn në Hierore dhe qëndron në të majtë të priftit, falet tre herë duke puthur Tryezën e shenjtë; si merr një Mbulesë, e lëviz me shpresëtarin mbi të Shenjtat.

Prifti lexon Anaforën e shenjtë:

Prifti:

(pa zë) O Kryezot, që je Zot Perëndi, Atë i tërëfuqishëm, i adhurueshëm, është me të vërtetë e denjë, e drejtë dhe e hijshme për madhësitinë e shenjtërisë sate, të të lavdërojmë, të të himnojmë, të të bekojmë, të të falemi, të të falënderojmë, të të madhështojmë, Ty që je me të vërtetë i vetmi Perëndi, dhe të të blatojmë me zemër të dërrmuar dhe me frymë përvulësie këtë adhurimin tonë shpirtëror; se Ti je ai që na fale njohjen e plotë të së vërtetës sate. Dhe cili është i zoti të flasë për pushtetin tënd, të bëjë që të dëgjoen lavdërimet e tua, ose të tregojë tërë çudirat e tua në çdo kohë? O Sundimtar i gjithësisë, Zot i qiellit e i dheut dhe i gjithë krijesës së dukshme dhe së padukshme, që rri mbi fronin e lavdisë, dhe mbikqyr thellësisht, që je i pafillim, i padukshëm, i pakuptueshëm, i papërshkrueshëm, i pandryshuar, Ati i Zotit tonë Iisu Krishtit, Perëndisë së madh dhe Shpëtimtarit, shpresës sonë; i cili është ikonë e mirësisë sate, shenjë e njëjtë, që me anën e vetes së tij, paraqet Ty Atin, Fjalë e gjallë, Perëndi i vërtetë, urtësia para shekujsh, jeta, shenjtërimi, fuqia, drita e vërtetë; me anën e të cilit u shfaq Shpirti i Shenjtë, Shpirti i së vërtetës, dhurata e adoptimit, garancia e trashëgimit të ardhshëm, fillimi i të mirave të përjetshme, fuqia jetëbërëse, burimi i shenjtërimit, prej të cilit duke marrë fuqi tërë krijesa shpirtërore dhe mendore, Të adhuron dhe Ty të drejton lavdinë e përjetshme, se të gjitha Ty të shërbejnë. Se Ty të lavdërojnë Engjëjt, Kryeengjëjt, Fronet, Zotërit, Kryesitë, Pushtetet, Fuqitë dhe Keruvimet me shumë sy; Ty të rrinë rreth e rrotull Serafimet me nga gjashtë krahë secili; me dy mbulojnë fytyrat e tyre, me dy këmbët, dhe me dy duke fluturuar i thërrasin njëri-tjetrit me klithma të pandërprera dhe lavdërime të papushuara,

(me zë të lartë) Himnin triumfal, duke kënduar, duke britur, duke thirrur dhe duke thënë:

Psaltët:

Shenjt, Shenjt, Shenjt, Zoti Savaoth, qielli e dheu janë

plot me lavdinë tënde; Hosana Ti në më të lartat. I bekuar është ai që vjen në emrin e Zotit. Hosana Ti në më të lartat.

Dhiaku ngre Yllin nga Qengji dhe e palos dysh, bën shenjë e Kryqit mbi Dhiskun dhe fshin lehtë anët e tij mbi Andiminsin. Pastaj e puthin atë Prifti dhe Dhiaku i cili e vendos mbi Ajrin e palosur dhe shkon në krahë të djathtë të Priftit. Prifti duke ulur kryet, thotë:

Prifti:

(pa zë) Bashkë me këto Fuqi të lumtura, o Zot njeridashës, edhe ne mëkatarët thërresim dhe themi: I Shenjtë je me të vërtetë dhe i tërëshenjtë, dhe s'ka masë për madhësinë e shenjtërisë sate, dhe i drejtë në të gjitha veprat e tua; se na i solle të gjitha me drejtësi dhe gjykim të vërtetë; se duke formuar njeriun me baltë prej dheut dhe duke nderuar me ikonën tënde, o Perëndi, e vendose në parajsën e dëfrimit dhe i premtovë pavdekësinë e jetës dhe shijimin e të mirave të përjetshme, po të ruante porosinë e Tua. Po meqenëse nuk të dëgjoji Ty Perëndinë e vërtetë që e krijove dhe u tërhoq nga mashtrimi i gjarpërit e iu përdha vdekjes nga fajet e veta, dhe me gjykimin tënd të drejtë, o Perëndi, e nxore jashtë parajsës dhe e ktheve në dhe prej të cilit u mor, duke i përgatitur atij shpëtimin me anën e rilindjes që është në vetë Krishtin tënd. Se nuk e neverite deri në fund krijesën tënde që bëre, o i Mirë, as që harrove veprën e duarve të Tua, po ia shtive sytë në shumë mënyra nga zemërdhembshuria jote: Dërgove profetë, bëre çudira me anën e shenjtoreve të tu të çdo brezi që të kanë pëlqyer; na fole me gojën e shërbëtorëve të tu, profetëve, duke na paralajmëruar shpëtimin që do të vinte; ke dhënë ligj për ndihmë; vure Engjëj ruajtës. Dhe kur erdhi koha e caktuar, na fole me vetë Birin tënd, me anën e të cilit bëre dhe shekujt; i cili është shkëlqimi i lavdisë sate dhe tip i personit tënd dhe duke i patur të gjitha me fjalën e fuqisë së Tij, qenien e tij të barabartë me Ty, Perëndinë dhe Atin, nuk e quajti si gjë të rrëmbyer; po meqenëse ishte Perëndi para jetëve,

u duk mbi dhe, dhe u shoqërua me njerëzit; dhe duke u trupëzuar prej Virgjëreshës së Shenjtë, e përu li veten dhe mori formë shërbëtori, duke u bërë një me formën e trupit tonë të përlur, që të na bëjë dhe ne njësoj me formën e ikonës të lavdisë së Tij. Sepse me që mëkati erdhi në botë me anën e njeriut, dhe nga shkaku i mëkatis vdekja, prandaj Biri yt i vetëmlindur që është në gjirin tënd, o Perëndi dhe Atë, dhe që lindi prej gruaje, prej Hyllindëses së Shenjtën dhe gjithmonë Virgjëreshës Mari, i u nënshtrua ligjës dhe denjoi të dënojë mëkatin në trupin e tij; në mënyrë që, ata që vdesin më Adamin, të ngjallen në vetë Krishtin tënd; dhe duke jetuar në këtë botë, duke dhënë porosira shpëtimi, duke na larguar nga gënjeshttrat e idhujve, na solli në njohjen tënde, Perëndisë së vërtetë dhe Atit, dhe na bëri për veten e tij popull të zgjedhur, priftëri mbretërore, komb të shenjtë; dhe duke na pastruar me ujë, dhe duke na shenjtëruar me Shpirtin e Shenjtë, dha veten këmbim te vdekja prej së cilës mbaheshim të shitur nga mëkati; dhe duke zbritur me anën e Kryqit në Ferr që të plotësojë tërë misionin e Tij, zhduku dhimbjet e vdekjes; dhe pasi u ngjall të tretën ditë dhe i çeli çdo trupi rrugën e ngjalljes prej së vdekurish, meqë nuk ishte e mundur të zotërohej prej prishjes kryetari i jetës, u bë fillimi i të fjeturve, i paralinduri i të vdekurve, që të jetë Ai gjithçka, duke qenë i pari në të gjitha; dhe si u ngjit në qiejt, ndenji më të djathtë të madhërisë sate në më të lartat; i cili dhe do të vijë që t'i japë secilit simbas veprave të tij. Dhe na la si kujtim të pësimit të Tij shpëtimtar këto që të kemi vënë përpara sipas porosive të Tij. Se kur do të nisej me dashje për te vdekja e Tij e gjithmonëkujtuar dhe jetëbërëse, natën në të cilën dorëzonte veten e Tij për jetën e botës, mori bukë në duart e Tij të shenjta dhe të kulluara dhe duke ta treguar Ty, Perëndisë dhe Atit, si falenderoi, bekoi, shenjtëroi, dhe e preu;

(më zë të lartë) Ua dha nxënësve dhe apostujve të Tij të shenjtë, duke thënë:

Merrni, hani, ky është Trupi im, që thyhet për juve për ndjesën e mëkateve.

Psaltët: Amin.

Dhiaku duke mbajtur Orarin e tij, tregon edhe ai, bashkë me priftin Dhiskun e shenjtë.

Prifti: *(pa zë)* Gjithashtu, duke marrë dhe Potirin me pemën e vreshtit, si e përzjeu, falenderoi, bekoï dhe e shenjtëroi,

(me zë të lartë) Ua dha nxënësve dhe apostujve të Tij të shenjtë, duke thënë:

Pini prej këtij të gjithë, ky është Gjaku im i Dhiatës së Re, që derdhet për ju dhe për shumë për ndjesën e mëkateve.

Psaltët: Amin.

Dhiaku bashkë me prifti tregojnë Potirin e shenjtë; prifti përseri duke ulur kryet thotë:

Prifti: *(pa zë)* Bëjeni këtë për kujtimin tim; se sa herë që hani këtë bukë dhe pini këtë kupë, vdekjen time lëçitni dhe ngjalljen time rrëfeni. Duke kujtuar pra, o Zot, edhe ne, pësimet e Tij shpëtimtare, Kryqin jetëbërës, varrimin e triditshëm, ngjalljen prej së vdekurish, ngjitjen në qiejt, të ndenjurit nga e djathta jote, Perëndisë dhe Atit, dhe ardhjen e Tij të dytë të lavdishme dhe të frikshme;

Prifti, duke ngritur lartë, në formë kryqi, Dhiskun me dorën e djathtë dhe Potirin me të majtën, thotë:

Prifti: *(me zë të lartë)* Të tuat nga të tuat, ty të blatojmë nga të gjitha dhe për të gjitha.

Psaltët: Të himnojmë, të bekojmë, Ty të falenderojmë, o Zot, dhe të lutemi, Perëndia ynë.

Prifti duke ulur kryet, thotë këtë uratë:

Prifti: *(pa zë)* Prandaj, o Zot i tërëshenjtë, dhe ne shërbëtorët e tu mëkatarë e të pamerituar, që u bëmë të denjë t'i shërbejmë altarit tënd të shenjtë, jo për drejtësitë tona, se nuk kemi bërë ndonjë të mirë mbi dhe, por nga mëshirat dhe përdëllimet e tua, që i derdhe me shumicë mbi ne, me guxim i afrohem altarit tënd të shenjtë; dhe duke vënë përpara ato që paraqesin Trupin dhe Gjakun e shenjtë të Krishtit tënd, të falemi dhe të lutemi, o shenjt i shenjtëve, që, me dëshirën e mirësisë sate; të vijë Shpirti yt i Shenjtë mbi ne dhe mbi këto Dhurata që janë vënë përpara dhe t'i bekojë ato dhe t'i shenjtërojë edhe t'i bëjë,

Prifti dhe dhiaku falen tri herë duke bërë tri metani përpara Tryezës së shenjtë dhe duke thënë:

(pa zë) O Perëndi, falmë mua mëkatarin dhe mëshiromë.

Pastaj dhiaku duke mbajtur Orarin me tre gishta dhe duke treguar Bukën e shenjtë që ndodhet në Dhisk, thotë:

Dhiaku: *(pa zë)* Beko, o Zot, Bukën e shenjtë.

Prifti duke bekuar Bukën e shenjtë, tri herë, thotë:

Prifti: *(pa zë)* Këtë bukë, vetë Trupin e çmuar të Zotit dhe Perëndisë dhe Shpëtimtarit tonë Iisu Krisht.

Dhiaku: Amin.

Dhe duke treguar Potirin e shenjtë thotë:

Dhiaku: *(pa zë)* Beko, o Zot, Potirin e shenjtë.

Prifti duke bekuar Potirin e shenjtë thotë:

Prifti: *(pa zë)* Dhe atë që është në këtë Potir, vetë Gjakun e çmuar të Zotit dhe Perëndisë dhe Shpëtimtarit tonë Iisu Krisht, që u derdh për jetën dhe shpëtimin e botës.

Dhiaku: Amin.

Dhe duke treguar që të dyja (Dhiskun dhe Potirin) thotë:

Dhiaku: *(pa zë)* Beko, o Zot, që të dyja të shenjtat.

Prifti, duke i bekuar në formë Kryqi Bukën e shenjtë dhe Potirin e shenjtë, thotë:

Prifti: Duke i ndryshuar me anën e Shpirtit tënd të Shenjtë.

Dhiaku: Amin. Amin. Amin.

Dhiaku merr Ajrin e palosur dhe e lëviz mbi të Shenjtat.

Prifti: *(pa zë)* Dhe ne të gjithë që marrim pjesë prej së njëjtës Bukë dhe Potirit, të na bashkosh me njëri-tjetrin në shoqërinë e të njëjtit Shpirt të Shenjtë, dhe mos lejo që kungimi me Trupin dhe Gjakun e shenjtë të Krishtit tënd të jetë për gjykimin ose dënimin e asnjërit prej nesh, po që të gjejmë mëshirë dhe hir me gjithë shenjtoret që të kanë pëlqyer prej shekujsh, stërgjyshët, etërit, patrikët, profetët, apostujt, predikuesit, ungjillëzuesit, martirët, konfesorët, mësuesit dhe me çdo shpirt të drejtë që ka ndërruar jetë me besë.

Prifti merr temjanicën dhe duke temjanisur tri herë të Shenjtat, thotë:

Prifti: *(me zë të lartë)* Veçan për të Tërëshenjtën, të pacënuarën, të përmbibekuarën, të lavdëruarën, Zonjën tonë Hyjlin-dëse dhe gjithmonë Virgjërën Mari.

Te Enjten e madhe dhe të Shtunën e madhe psalet odja IX e ditës. Dhiaku merr temjanicën, temjanis Tryezën e shenjtë për qark, qëndron prapa Tryezës së shenjtë dhe kujton dhiptikët e të gjallëve dhe të vdekurve.

Psaltët: Me ty gëzohet, o Hirëplote, gjithë krijesa tërësia e engjëjve, dhe gjinia e njerëzve; o tempull i shenjtëruar dhe parajsë shpirtërore, mburrja e virgjërisë; prej së cilës u trupëzua dhe u bë djalë Perëndia ynë që është para jetëve. Se mitrën tënde e bëri fron, dhe barkun tënd më të gjërë se qiejt. Me ty gëzohet, o Hirëplote, gjithë krijesa; lavdi më ty.

Në këtë kohë Prifti duke u përkulur thotë:

Prifti:

(pa zë) Për profetin, pararendësin dhe pagëzorin Shën Joan; Apostujt e shenjtë të lavdëruar dhe të dëgjuar; shenjtin *(aksh të ditës)*, kujtimin e të cilit po bëjmë dhe gjithë shenjtorët e tu; me lutjet e të cilëve vështrona, o Perëndi. Dhe kujto gjithë ata që kanë ndërruar jetë me shpresë ngjalljeje për jetën e amëshuar; *(Këtu prifti përmend me emër të fjeturit që dëshiron)*; dhe prehi ata atje ku mbikqyr drita e fytyrës sate. Gjithashtu të lutemi, kujto, o Zot, Kishën tënde të shenjtë, të përgjithshme dhe apostolike, që është përhapur nga njera anë deri në tjetrën anë të botës, dhe fali paqen asaj, të cilën e fitove me Gjakun e çmuar të Krishtit tënd, dhe forcoje këtë shtëpi të shenjtë gjer në mbarim të jetës. Kujto, o Zot, ata që të sollën këto dhurata, ata për të cilët, dhe me anën e të cilëve u sollën si dhe për çka ato u sollën. Kujto, o Zot, ata që sjellin pemë dhe bëjnë të mira në kishat e tua të shenjta dhe që kujtojnë të varfërit; shpërblei me dhuratat e tua të pasura dhe qiellore; dhuroju qielloret në vend të të dheshmeve, të përjetshmet në vend të të përkohshmeve, ato që s'prishen në vend të atyre që prishen. Kujto, o Zot, ata që ndodhen në shkretëtira, dhe në male, dhe në shpella dhe në vrimat e dheut. Kujto, o Zot, ata që jetojnë me virgjëri dhe shpresëtari, dhe me asketizëm dhe me jetë të nderuar. Kujto, o Zot, udhëheqësit besnikë, që caktove për të drejtuar botën; kurorëzoi me armën e së vërtetës, me armën e dëshirës së mirë; qëndroi mbrojtës mbi krye në ditë lufte, forcoi krahun, lartësoja të djathtë, forcoi pushtetin, nënshtrojua kombet barbare që duan luftrat; falu paqe të thellë dhe të vazhdueshme; fol në zemrën e tyre fjalë të mira për Kishën tënde dhe për tërë popullin tënd; në mënyrë që nën qetësinë e tyre të kalojmë jetë të paturbulluar dhe të qetë, me shpresëtari dhe nder. Kujto, o Zot, çdo pushtet dhe vëllezërit tanë udhëheqës dhe tërë

ushtrinë. Të mirët ruaji me mirësinë tënde, të ligjtë bëji të mirë me mirëdashjen tënde. Kujto, o Zot, popullin që rri rrotull, dhe ata që për shkaqe të arsyeshme mungojnë, dhe mëshiroi ata dhe ne sipas mëshirës sate të shumtë. Shtëpitë e tyre mbushi me tërë të mirat; martesat e tyre ruaji me paqe dhe harmoni; foshnjat rriti; rininë edukoje; pleqërinë forcoje; ata me guxim të paktë, ngushëlloji; të shpërndarët mblidhi; të gabuarit rikthei dhe bashkoi me Kishën tënde të shenjtë, të përgjithshme dhe apostolike; të ngacmuarit prej frymësh të ndyra çliroi; lundro bashkë me lundruesit; udhëtarët shoqëroi; të vejat mbroi; jetimët përkrahi; robërit shpëtoi; të sëmuret shëroi. Kujto, o Perëndi, ata që ndodhen në gjyqe, në miniera, në internime, në robëri të hidhura, dhe në çdo dhembje, nevojë dhe mjerim. Kujto, o Perëndi, dhe gjithë ata që i luten zemërdhembshurisë sate të madhe; dhe ata që na duan dhe ata që na urrejnë dhe ata që na kanë porositur ne të padenjtë të lutemi për ta. Kujto, o Zot, Perëndia ynë, dhe gjithë popullin tënd dhe derdh mbi të gjithë mëshirën tënde të pasur, duke u falur të gjithëve ato që të lypin për shpëtim. Dhe ata të cilët ne nuk i kemi kujtuar nga padija, ose harresa ose nga shumica e emrave, kujtoi vetë, o Perëndi, ti që di moshën dhe emrin e secilit, Ti që e njeh secilin që nga barku i nënës së tij. Se Ti je, o Zot, ndihma e atyre që s'kanë ndihmë, shpresa e të dëshpëruarve, shpëtimtari i atyre që turbullohen nga dallgët e jetës, limani i lundruesve, mjeku i të sëmurve. Bëhu gjithçka për të gjithë, Ti që njeh secilin dhe kërkesën e tij, shtëpinë dhe nevojën e tij. Shpëto, o Zot, këtë qytet (ose manastir) dhe çdo qytet e vend, prej urisë, sëmundjes, tërmetit, përmbytjes, zjarrit, thikës, sulmit të armiqve dhe luftës civile.

(me zë të lartë) Më parë kujto, o Zot, Kryepiskopin (ose episkopin) tonë (aksh), të cilin falua Kishave të tua të shenjta, me paqe, të sigurt, të nderuar, të shëndetshëm jetëgjatë dhe shpjegues të drejtë të së vërtetës sate.

Dhiaku: Dhe ato që ka cilido ndërmend dhe të gjithë e të gjitha.

Psaltët: Dhe të gjithë e të gjitha.

Prifti duke u përkulur thotë:

Prifti: *(pa zë)* Kujto, o Zot, çdo episkopatë orthodhoksësh që përcaktojnë drejt fjalën e së vërtetës sate. Kujtomë, o Zot, sipas dhembshurive të tua të shumta dhe mua të padenjin; falmë çdo mëkat të bërë me dashje ose pa dashje, dhe mos e ndalo hirin e Shpirtit tënd të Shenjtë nga dhuratat e paravëna për shkak të mëkateve të mia. Kujto, o Zot, priftërinë, dhiakonatin më Krishtin dhe çdo rrjesht priftëror dhe mos turpëro asnjë prej nesh që qëndrojmë rreth altarit tënd të shenjtë. Shtjer sytë mbi ne me mirësinë tënde, o Zot; shfaqu ndër ne me dhembshuritë e tua të pasura; falna erërat të mira dhe të dobishme; dhuroi tokës shira të qetë për të prodhuar pemë; beko tërë vitin me mirësinë tënde; pushoi përçarjet e Kishave, shuaji sulmet e tërbuara të paganëve; shtypi shpejt kryengritjet e herezive me fuqinë e Shpirtit tënd të Shenjtë; pranona të gjithë ne në mbretërinë tënde duke na bërë bij drite dhe bij dite; falna, o Zot Perëndia ynë, paqen tënde dhe dashurinë tënde; sepse të gjitha na i ke dhënë.

(me zë të lartë) Dhe jepna që me një gojë dhe me një zemër, të lavdërojmë dhe të himnojmë emrin tënd të gjithënderuar dhe madhështor, të Atit e të Birit dhe të Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve.

Psaltët: Amin.

Prifti kthehet nga populli, e bekon dhe thotë:

Prifti: Dhe do të jenë mëshirat e Perëndisë së madh dhe Shpëtimtarit tonë Iisu Krisht me ju të gjithë.

Psaltët: Dhe në shpirtin tënd.

Dhiaku merr qeron prej Priftit, del nga Hierorja dhe pasi qëndron në vendin e zakonshëm, thotë:

Dhiaku: Pasi kujtuam gjithë shenjtorët, përsëri dhe përsëri me paqe, le t'i lutemi Zotit.

Psaltët: Mëshiro, o Zot.

Dhiaku: Për Dhuratat e çmuara, që u blatuan dhe u shenjtëruan, le t'i lutemi Zotit.

Psaltët: Mëshiro, o Zot.

Dhiaku: Që Perëndia ynë njeridashës, i cili i pranoi ato si aromë shpirtërore në altarën e tij të shenjtë, qiellor dhe të kuptuar me anën e mendjes, të na dërgojë si shpërblim hirin hyjnor dhe dhuratën e Shpirtit të Shënjtë, le të lutemi.

Psaltët: Mëshiro, o Zot.

Dhiaku: Që të shpëtojmë prej çdo hidhërimi, zemërimi, rreziku dhe nevoje, le t'i lutemi Zotit.

Ndërkaq prifti thotë këtë uratë përpara Tryezës së shenjtë:

Prifti: *(pa zë)* O Perëndia ynë, Perëndia i shpëtimit, Ti mësona të të falenderojmë si duhet për mirëbërjet e tua që na ke bërë dhe po na bën. Ti o Perëndia ynë, që pranove këto Dhurata, pastrona prej çdo ndyrësie trupi dhe shpirti, dhe mësona të bëjmë punë të shenjta me frikën tënde dhe me dëshminë e pastër të ndërgjegjes sonë; duke marrë pjesën prej dhuratave të shenjta, të bashkohemi me Trupin dhe Gjakun e shenjtë të Krishtit tënd; dhe si t'i marrim këto ashtu si duhet, të kemi Krishtin banues në zemrat tona dhe të bëhemi tempull i Shpirtit tënd të Shenjtë. Po, o Perëndia ynë, dhe asnjë prej nesh të mos e bësh fajtor për këto misteret e tua të frikshme dhe qiellore, as të sëmurë nga shpirti dhe trupi, që mund të jetë kunguar me këto duke qenë i padenjë; por jepna që deri në frymën tonë të fundit të marrim si duhet pjesën e dhuratave të Tua të shenjta, si mjet për jetën e përjetshme, si mbrojtje të mirëpritur përpara gjykatës së trembshme të Krishtit tënd; në mënyrë që edhe ne bashkë me gjithë shenjtorët

që të kanë pëlqyer prej shekujsh, të bëhemi pjesëtarë të të mirave të Tua të përjetshme, të cilat i përgatite për ata që të duan, o Zot.

Dhiaku: Përkrahna, shpëtona, mëshirona dhe ruajna, o Perëndi, me hirin tënd.

Psaltët: Mëshiro, o Zot.

Dhiaku: Ditën të tërë, të përsosur, të shenjtë, me paqe dhe të pamëkatshme, le t'i a lypim Zotit.

Psaltët: Falna, o Zot.

Dhiaku: Engjëll paqeje, udhëheqës besnik, ruajtës të shpirtave dhe të trupave tanë, le t'i lypim Zotit.

Psaltët: Falna, o Zot.

Dhiaku: Ndjesë dhe falje të mëkateve dhe të fajeve tona, le t'i lypim Zotit.

Psaltët: Falna, o Zot.

Dhiaku: Të mirat dhe të dobishmet për shpirtat tanë dhe paqe për botën, le t'i lypim Zotit.

Psaltët: Falna, o Zot.

Dhiaku: Që të kalojmë në paqe dhe në pendim jetën që na mbetet, le t'i lypim Zotit.

Psaltët: Falna, o Zot.

Dhiaku: Mbarim të krishter të jetës sonë, pa dhembje, faqebardhë, me paqe dhe mbrojtje të mirë përpara gjykatores së trembshme të Krishtit, le të lypim.

Psaltët: Falna, o Zot.

Dhiaku: Duke lypur bashkimin e besës dhe pjesëmarrjen e Shpirtit të Shenjtë, veten tonë dhe njeri-tjetrin dhe gjithë jetën tonë, Krishtit Perëndisë, le t'ia parashtrijmë.

Psaltët: Ty, o Zot.

Prifti: *(me zë të lartë)* Dhe bëna të denjë, o Zot, që pa drojtje e pa dënim të guxojmë të të thërresim Atë, Ty Perëndinë qiellor, e të themi:

Psaltët: Ati ynë që je në qiejt; u shenjtëroftë emri yt, ardhhtë mbretëria jote, u bëftë dëshira jote si në qiell ashtu edhe mbi dhe. Bukën tonë të përditshme jepna neve sot; dhe falna fajet tona, sikurse edhe ne ua falim fajtorëve tanë; dhe mos na shtjer në ngasje, po shpëtona nga i ligu.

Prifti: *(me zë të lartë)* Se jotja është mbretëria dhe fuqia dhe lavdia e Atit, e Birit edhe e Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve.

Psaltët: Amin.

Prifti, duke bekuar popullin, thotë:

Prifti: Paqe në të gjithë.

Psaltët: Dhe në shpirtin tënd.

Dhiaku: Kryet tanë le t'i a ulim Zotit.

Psaltët: Ty, o Zot.

Prifti, duke përkulur thotë:

Prifti: *(pa zë)* O Zot, Ati i dhembshurive dhe Perëndi i çdo ngushëllimi, ata që kanë ulur kryet përpara Teje, bekoj, shenjtëroi, ruaji, mbroi, forcoj, largoj nga çdo vepër e keqe; bashkoi me çdo vepër të mirë; dhe bëji të denjë që pa dënim të marrin pjesë në këto Misteret e tua të kulluara e jetëbërëse, për ndjesë mëkatesh, për bashkimin me Shpirtin e Shenjtë.

(me zë të lartë) Me hirin dhe dhembshuritë dhe njeridashjen e Birit tënd të vetëmlindur, me të cilin je i bekuar, bashkë me Shpirtin tënd të tërëshenjtë dhe të mirë e jetëbërës, tani e përherë e në jetë të jetëve.

Psaltët: Amin.

Prifti, duke u përkulur, thotë:

Prifti: *(pa zë)* Vër re, o Zot Iisu Krisht, Perëndia ynë, nga banesa jote e shenjtë dhe nga fronti i lavdisë së mbretërisë sate, dhe eja të na shenjtërosh, Ti që rri lart bashkë me Atin dhe që je këtu padukurisht bashkë me ne; dhe me dorën tënde të fuqishme denjo të na japësh Trupin tënd të pacënuar dhe Gjakun tënd të çmuar dhe me anën tonë gjithë popullit.

Dhe falet tri herë duke thenë pa zë:

O Zot, falmë mua mëkatarin dhe mëshiomë *(tri herë)*.

Në këtë kohë kur prifti lexon këtë uratë, dhiaku qëndron në vendin e zakonshëm, përpara derës së Bukur dhe e ngjesh Orarin kryq; pastaj si mbaron urata thotë:

Dhiaku: *(me zë të lartë)* Le të vëmë re.

Prifti, pas një perkuljeje të vogël, merr Bukën e Shenjtë me të dy duart, e ngre lartë në formë kryqi e thotë me respekt e shpresëtari:

Prifti: *(me zë të lartë)* Të Shenjtat, të shenjtëve.

Psaltët: Një është Shenjt, një është Zot, Iisu Krishti, për lavdi të Perëndisë Atit. Amin.

Dhe menjëherë këndohet Qionikoja:

Psaltët: Lavdërojeni Zotin prej qiejve, lavdërojeni në më të lartat. Alilua.

Të Enjten e Mathe këndohet Qionikoja: «Ne Darkën tënde mistike, ...»

Qionikoja e së Shtunës së madhe, tingulli I:

Zoti u ngrit si prej gjumi, dhe u ngjall duke na shpëtuar. Alilua.


Pastaj dhiaku hyn në Hierore dhe duke qëndruar në anën e djathtë të priftit, i cili mban Bukën e shenjtë, thotë:

Dhiaku: Copëto, o Zot, Bukën e shenjtë.

Prifti e copëton në katër pjesë me kujdes dhe shpresëtari, duke thënë:

Copëtohet dhe pjesëtohet Qengji i Perëndisë, i cili copëtohet dhe nuk përndahet, i cili hahet gjithnjë dhe nuk mbarohet kurrë, por shenjtëron ata që kungohen.

Prifti i rregullon të katër pjesët e Bukës mbi Dhiskun e shenjtë në formë kryqi:



Dhe dhiaku, duke treguar Potirin e Shenjtë, thotë:

Mbush, o Zot, Potirin e shenjtë.

Dhe Prifti, se merr meridhën e sipër me të Qëngjit që ka shkronjat IS, bën me të shenjën e kryqit mbi Potirin (nga njëra buzë në tjetën) e thotë:

Mbushja e Potirit me Shpirt të Shenjtë.

Dhe e vendos atë brenda në Potirin e Shenjtë.

Dhiaku thotë: Amin.

Dhe si merr ujin e nzehtë, i thotë priftit:

Beko, o Zot, ujët e nzehtë.

Prifti e bekon dhe thotë:

E bekuar është nxehtësia e shenjtorëve të tu, o Zot, gjithnjë; tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Dhiaku duke mbajtur me kujdes, me dorën e majtë, Potirin e shenjtë, derdh ujin e nevojshëm në Potir në formë kryqi. Dhe Prifti thotë:

Prifti: Nxehtësi e besës, plot me Shpirt të Shenjtë.

Dhiaku: Amin.

Dhiaku, si vendos enën me ujin e nxehtë në vendin e tij, qëndron pak më lart duke u falur me vete.

Kurse prifti kokulur lexon me shpresë këto urata para kungimit:

Besoj, o Zot, dhe pohoj se Ti je me të vërtetë Krishti, Biri i Perëndisë së gjallë, që erdhe në botë të shpëtosh mëkatarët, nga të cilët i pari jam unë. Gjithashtu besoj se ky është vetë Trupi yt i pacënuar dhe ky është vetë Gjaku yt i çmuar. Të lutem pra, mëshiromë dhe falmi fajet, të bëra me dashje dhe pa dashje, me fjalë, me punë, me dije dhe padije; dhe bëmë të denjë që të marr pjesë pa dënim në misteret e tua të pacënuara, për ndjesën e mëkateve dhe për jetën e amëshuar. Amin.

Pastaj thonë këto vargje:

Ja tek po shkoj për kungatën hyjnore,
O krijues mos më digj me anën e kungatës;
Se Ti je zjarr që djeg të padenjët.
Por pastromë prej çdo njolle.

Dhe këtë tropar:

Në Darkën tënde mistike, o Bir i Perëndisë, merrmë sot pjesëtar; se nuk do t'ua them armiqve të tu Misterin; nuk do të të jap të puthur si Iuda por duke të pohuar si kusari, thërres: Kujtomë, o Zot, në mbretërinë tënde.

Dhe këto vargje:

O njeri, dridhu, duke parë gjak hyjnizues;
Se është thëngjill që djeg të padenjët;
Trupi i Perëndisë, dhe më hyjnizon dhe më ushqen;
Shpirtin e hyjnizon dhe mendjen e ushqen çuditërisht.

Dhe këto tropare:

Më ngazëllove me mallin tënd, o Krisht, dhe më ndryshove me dashurinë tënde hyjnore; po digji me zjarr të palëndshëm mëkatet e mia dhe bëmë të denjë të nginjem me ëmbëlsirën tënde, që duke kërcyer të madhëroj, o i Mirë, të dyja ardhjet e tua.

Ndër shkëlqimet e shenjtorëve të tu si do të hyj unë i padenji? Se në guxofsha të hyj bashkë në nusëroren, rroba më tregon se s'është e dasmës, dhe i lidhur do të nxirrem jashtë prej engjëjve. Pastro, o Zot, ndyrësinë e shpirtit tim dhe shpëtomë si njeridashës.

Pastaj këtë uratë:

O Zot njeridashës, Zoti Iisu Krisht, Perëndia im, të mos jenë për dënimin tim, pasi jam i padenjë, por për pastrim dhe shenjtërim të shpirtit dhe të trupit dhe për sigurim të jetës dhe mbretërisë së ardhshme. Për mua është mirë t'i ngjitem Perëndisë dhe të vë te Zoti shpresën e shpëtimit tim.

Dhe përsëri:

Në Darkën tënde mistike, o Bir i Perëndisë, merrmë sot pjesëtar; se nuk do t'ua them armiqve të tu misterin; nuk do të të jap të puthur si Iuda, por duke të pohuar si kusari, thërres: Kujtomë, O Zot, në mbretërinë tënd.

Pastaj prifti, duke ardhur që të kungohet, i thotë dhiakut ose priftërinjve të tjerë që meshojnë së bashku:

O vëlla dhe bashkëmeshëtar, ndjemë, mua mëkatarin.

Dhe Dhiaku përgjigjet:

Prifiterinë tënde e kujtoftë Zoti Perëndia në mbretërinë e Tij, gjithnjë; tani e përherë e në jetë të jetëve.

Pastaj, prifti thotë:

O Perëndi, falmë mua mëkatarin dhe mëshiromë (*tri herë*).

Dhe si u afrohet të Shenjtave me frikë dhe shpresë, merr një pjesë nga Trupi i shenjtë (nga pjesa që ka shkronjat IS) dhe thotë:

Ja tek vij te Krishti, mbreti i pavdekshëm dhe Perëndia ynë.

Trupi i çmuar dhe i tërëshenjtë i Zotit Perëndisë dhe Shpëtimtarit tonë Iisu Krisht, më jepet mua, priftit të padenjë (*aksh*), për ndjesën e mëkateve të mia dhe për jetën e amëshuar.

Dhe si kungohet me Trupin e shenjtë thotë:

Amin.

Pastaj i thotë dhiakut:

Dhiak, afrohu.

Dhiaku duke ardhur dhe duke hapur duart ne formë kryqi, duke pasur pëllëmbën e djathtë mbi të majtën, thotë:

Ja tek vij te Krishti, Mbreti i pavdekshëm dhe Perëndia ynë.

Jepmë, o Zot, mua dhiakut të padenjë (*aksh*) Trupin e çmuar dhe të shenjtë të Zotit dhe Perëndisë dhe Shpëtimtarit tonë Iisu Krisht, për ndjesën e mëkateve të mia dhe për jetën e amëshuar.

Prifti duke i dhënë një pjesë nga Trupi i shenjtë, thotë:

Të jepet ty, (*aksh*) dhiakut shprësetar, Trupi i çmuar dhe i shenjtë i Zotit dhe Perëndisë dhe Shpëtimtarit tonë Iisu Krisht, për ndjesën e mëkateve të tua dhe për jetën e amëshuar.

Dhe dhiaku, pasi puth dorën e priftit, merr Bukën e Shenjtë,

shkon prapa Tryezës së hirshme dhe duke ulur kryet, kungohet. Këtë e bëjnë edhe priftërinjtë ose dhiakonët e tjerë kur bashkëmeshojnë.

I pari i pritërinjve, pasi të jetë kunguar me Trupin e nderuar, ia dorëzon atë Dhiakut.

Pastaj prifti merr mbulesën dhe ai e mbështet mirë te nofulla e tij, merr me të dy duart dhe me mbulesën Potirin e shenjtë dhe thotë:

Gjithashtu më jepet mua (*aksh*), priftit të padenjë, Gjaku i çmuar i tërëshenjtë i Zotit dhe Perëndisë dhe Shpëtimtarit tonë Iisu Krishtit, për ndjesë mëkatesh dhe jetë të pasosur.

Dhe kungohet tri herë, pa thënë gjë; fshin mirë buzët e tij dhe buzët e Potirit të shenjtë me Mbulesën që mban në dorë; e ngre Potirin lart, e puth edhe thotë:

Ky prëku buzët e mia, dhe Zoti do të më heqë gjithë paudhësitë dhe do të më pastrojë nga mëkatet.

Dhiak, afrohu përsëri.

Dhe dhiaku vjen para Tryezës së Shenjtë, shin pëllëmbën mbi dhiskun dhe thotë me vëmendje:

Jepmë, o Zot mua (*aksh*), dhiakut të padenjë, Gjakun i çmuar dhe i tërëshenjtë të Zotit dhe Perëndisë dhe Shpëtimtarit tonë, Iisu Krisht, për ndjesë mëkatesh dhe jetë të pasosur.

Dhe prifti e kungon atë tri herë me Potirin duke thënë:

Të jepet ty (*aksh*), dhiaku shpresëtar, Gjaku i çmuar dhe i Tërëshenjtë i Zotit dhe Perëndisë dhe Shpëtimtarit tonë, Iisu Krishtit, për ndjesë të mëkateve të tua dhe për jetë të pasosur. Amin.

Pastaj, si pastron edhe ky me Mbulesën buzët e veta e të Potirit të Shenjtë, puth Potirin.

Dhe prifti, duke ngritur Potirin lart, thotë:

Ky preku buzët e tua dhe Zoti do të falë gjithë paudhësitë e tua e do të pastrojë mëkatet e tua.

Pastaj dhiaku merr Dhiskun e shenjtë me dorën e majtë dhe me të dy gishtërinjtë e dorës së djathtë Sfungjerin dhe hedh pjesët e Trupit të Shenjtë (pjesët me gjerman KR, FI dhe TON), të cilat i ndan në pjesë të vogla kur ka për të kunguar besimtarët, në Potirin e Shenjtë me kujdes e thotë:

Ne që pamë ngjalljen e Krishtit, le t'i falemi të shenjtit, Zotit Iisu, të vetmit të pamëkatshëm. Kryqit tënd po i falemi, o Krisht, dhe ngjalljen tënde të shenjtë himnojmë dhe lavdërojmë; se Ti je Perëndia ynë, veç teje nuk njohim tjetër, emrin tënd përmendim. Ejani gjithë besimtarët t'i falemi ngjalljes së shenjtë të Krishtit. Se ja tek erdhi gëzim në tërë botën, me anën e Kryqit. Duke bekuar kurdoherë Zotin, himnojmë ngjalljen e Tij; se duke duruar Kryqin për ne, me vdekje vdekjen e zhduku.

Ndriçohu, ndriçohu, o Jerusalem i ri, se lavdia e Zotit lindi përmbi ty. Vallëzo tani dhe ngazëllohu, o Sion, dhe ti, o Hyjlindëse e kulluar, dëfre me ngjalljen e Birit tënd.

O zëri yt i hyjshëm, i dashur edhe fort i ëmbël; se me të vërtetë u zotove të jesh bashkë me ne gjer në mbarim të jetës, o Krisht; të cilin zë duke e patur ne besimtarët si ankurë shprese, ngazëllohemi.

O Krisht, Pashkë e madhe dhe fort e hirshme, o urtësi dhe Fjalë dhe fuqi e Perëndisë, jepna që më qartë të marrim pjesë me Ty në ditën e paperënduar të mbretërisë sate.

Kur prifti ka për të kunguar besimtarët, nuk duhet t'i shtjerë pjesët e tjera, por vetëm pjesët që përfaqësojnë Trupin e Zotit, dhe si të kungojë besimtarët, i shtie dhe pjesët e tjera, duke thënë:

Laji, o Zot, mëkatet e shërbëtorëve të tu që u kujtuan këtu me Gjakun tënd të shenjtë, me ndërmjetimet e Hyjllindëses dhe të gjithë shenjtorëve të tu. Amin.

Si të ketë fshirë mirë Dhiskun e shenjtë, merr në formë kryqi, katër cepat e Andiminsit të shenjtë, dhe i mban ne dorën e majtë; kurse me anë të dorës së djathtë merr pjesën e poshtëme të Andiminsit që varet dhe e shkund atë. Pastaj e hapë Andiminsin dhe, me anë të Lugës së shenjtë mbledhë therimet dhe i hedh në Potirin e shenjtë. Pastaj vendos vetëm Yllin mbi Dhiskun e shenjtë dhe mbi Yll vendos Mbulesat.

Prifti, pasi të ketë venë Lugën e shenjtë brenda në Potirin e shenjtë, ngre Potirin e shenjtë dhe ia jep dhiakut, i cili falet një herë; dhe si hapë Derën e Bukur prifti dhe kthehet drejt perëndimit (nga populli), dhiaku thote:

Dhiaku: Me frikë Perëndie, besë dhe dashuri, afrohuni.

Dhe bëhet kungimi i atyre që deshirojnë të kungohen. Nëse janë besimtarë që duan të kungohen, prifti merr nga duart e dhiakut Potirin e shenjtë dhe i kungon duke thënë:

Prifti: Kungohesh me Trupin e me Gjakun e Zotit dhe Perëndisë dhe Shpëtimtarit tonë Iisu Krisht, për ndjesë mëkatesh dhe jetë të përzetshme. Amin.

Në kohën kur prifti kungon besimtarët, psaltët këndojnë në menyre recitative një herë apo më shumë herë, sipas numurit të atyre që kungohen, troparin:

Psaltët: Ne Darkën tënde mistike...

Si të mbarojë së kunguari, prifti bekon popullin, duke e mbajtur Potirin e Shenjtë dhiakoni, e duke thënë:

Prifti: O Perëndi, shpëto popullin tënd dhe beko trashëgimin tënd.

Psaltët: Pamë dritën e vërtetë, morëm frymën qiellore, gjetëm besën e vërtetë, duke iu falur Trinis së pandarë, se ajo na shpëtoi.

Në disa të kremte të të caktuara, në vend të «Pamë dritën...» thuhet këto mëposhtë:

Më 1 janar: «Fytyrë të njerëzishme...»

Të Enjtën e Madhe: «Në darkën tënde mistike...»

Te Shtunën e Madhe: «Kujtona, o Zot edhe ne, siç kujtove kusarin në mbretërinë e qiejve».

Dhe kthehen të dy, prifti e dhiaku, në Tryezën e Shenjtë. Dhiaku vendos mbi të Potirin e shenjtë e i thotë priftit:

Dhiaku: Lartësoje, o Zot.

Dhe prifti, si temjanis tri herë të Shenjtat, thotë me zë të ulët:

Prifti: Lartësohu permby qejt, o Perëndi, dhe lëndia jote mbi tërë botën (*tri herë*).

Pastaj i jep dhiakut Dhiskun e shenjtë bashkë me Mbulesat; dhe ky duke i mbajtur me të dyja duartë lart mbi ballin, bën një përkulje para popullit dhe duke kaluar rreth Tryezës së Shenjtë, i shpie në Proskomidhi, kurse prifti, si falet, merr Potirin e shenjtë të mbuluar dhe thotë me zë të ulët para Tryezës së Shenjtë:

Prifti: (*pa zë*) I bekuar është Perëndia ynë,

Dhe duke u kthyer pastaj nga populli, thotë:

Prifti: (*me zë të lartë*) Gjithnjë; tani e përherë e në jetë të jetëve.

Dhe e vendos Potirin e Shenjtë mbi Proskomidhinë.

Psaltët: Amin.

Dhiaku del në vendin e zakonshëm, para Derës së Bukur, e thotë:

Dhiaku: Drejt! Pasi u kunguam me Misteret hyjnore, të shenjtat, të kulluara, të pavdekshme, qiellore, jetëbërëse dhe të frikshme të Krishtit, siç i meriton, le ta falenderojmë Zotin.

Përkrahna, shpëtona, mëshirona dhe ruajna, o Perëndi, me hirin tënd.

Psaltët: Mëshiro, o Zot.

Dhiaku: Ditën të tërë të përsosur, të shenjtë, me paqe dhe të pamëkatshme duke lypur, veten tonë dhe njëri-tjetrin dhe gjithë jetën tonë, Krishtit Perëndisë, le t'ia parashtrojmë.

Dhe hyn në Hierore.

Psaltët: Ty, o Zot.

Prifti vendos Sfungjerin në Antimins, të cilin e palos. Palosja bëhet kështu; së pari, paloset pjesa e sipërme, pastaj pjesa e poshtme e më në fund anët, e majta dhe e djathtë. Pjesa e sipërme mund të paloset dhe më dysh, që të mos mbulohet ana e jashtme e saj nga e brendshmja e pjesës së poshtme dhe gjatë palosjes të mos mbeten mbi të thërrmia. Në këtë mënyrë, ana e brendshme mbulon njëra-tjetrën.

Dhe si e palos, e lë në qendër të Tryezës. Pastaj lexon këtë uratë falenderimi:

Prifti: *(pa zë)* Të falenderojmë, o Zot Perëndia ynë, për kungatën e mistereve të Tua të shenjta, të kulluara, të pavdekshme dhe qiellore, të cilat na i fale për mirëbërje, shenjtërim dhe shërim të shpirtave dhe të trupave tanë. Ti, o Zot i gjithësisë, jep që kungimi i Trupit dhe i Gjakut të shenjtë të Krishtit tënd të na bëhet besë e paturpëruar, dashuri pa hipokrizi, dituri e plotë, shërim shpirti dhe trupi, largim i çdo gjëje të kundërt me këto, ruajtje e porosive të tua, mbrojtje e mirëpritur përpara gjykatës së trembshme të Krishtit tënd.

(me zë të lartë) Se Ti je shenjtërimi ynë, dhe Ty ta drejtojmë lavdinë, Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve.

Psaltët: Amin.

Prifti bën shenjën e Kryqit me Ungjillin dhe e vë mbi Andiminsin e palosur. Pastaj kthehet nga populli dhe thotë:

Prifti: Me paqe le të shkojmë.

Dhiaku: Le t'i lutemi Zotit.

Psaltët: Mëshiro, o Zot (*tri herë*). Beko, o Zot i shenjtë.

Prifti thotë këtë uratë përpara ikonës së Iisu Krishtit:

Prifti: (*me zë*) Ti që pranove këtë therore shpirtërore e të pagjakshme si therore lavdërimi e adhurimi të mirëpëlqyer nga ata që të janë lutur me gjithë zemër, o Krisht Perëndia ynë, Qëngji dhe Biri i Perëndisë që ngre mëkatin e botës; viçi i panjollshëm që nuk mban zgjedhë mekatesh, që u flijove për ne me dashje; Ai që copëtohet dhe që nuk ndahet, që hahesh e nuk sosesh dhe që ata që të hanë i shenjteron; Ti, që për kujtim të pësimit tënd vullnetar dhe të ngjalljes sate të triditshme e jetëbërëse na tregove pjeshëtarë të Mistereve të tu të patreguar, qiellorë e të frikshëm dhe të Trupit tënd të shenjtë dhe të Gjakut tënd të çmuar; mbana ne shërbetorët e tu, priftërinjtë, dhiakët, qeveritarët tanë, ushtërinë dhe mbarë popullin që qëndron rretull, në shenjtërimin tënd. Dhe epna në çdo kohë e në orë të mesojmë drejtësinë tënde, që, të udhëhequr te vullneti yt e duke vepruar ato që janë të pëlqyera prej teje, të bëhemi të denjë edhe për të qëndruar në të djathtë tënde kur të vish për të gjykuar të gjallë e të vdekur. Vëllezërit tanë që janë nën robëri, çliroji, të sëmuret vizitoji, ata që ndodhen në rrezik në det, shpëtoji, dhe shpirtat e paraprehura me shpresën e jetës së përjetshme, prehji atje ku është drita e fytyrës satë dhe dëgjo i të gjithë ata që kanë nevojë për ndihmën tënde. Se Ti je dhënësi i të mirave dhe Ty ta drejtojmë lavdinë bashke me Atin tënd të pafillim e me Shpirtin tënd të tërëshenjtë, të mirë e jetëbërës, tani e përherë e në jetë të jetëve.

Mund të thuhet edhe e zakonshmjaja:

O Zot, që bekon ata që të bekojnë, dhe shenjtëron ata që kanë besim më Ty, shpëto popullin tënd dhe beko trashëgimin tënd; ruaje tërësinë e Kishës sate, shenjtëro ata që duan hijeshinë e shtëpisë sate. Ti shpërbleji ata me lavdi, me anën e fuqisë sate hyjnore, dhe mos na ler ne që shpresojmë më Ty. Fali paqe botës sate, Kishave të tua, priftërinjve, udhëheqësve tanë, ushtrisë dhe gjithë popullit tënd; se çdo dhënje e mirë dhe çdo dhuratë e përsosur, zbret që lartazi prej teje, Atit të dritave; dhe Ty ta drejtojmë lavdinë, falenderimin dhe faljen, Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve.

Kur është e kremte dhespotike, prifti thotë uratën e zakonshme të pas amvonit.

Psaltët: Amin.

Kur thuhet urata e pas amvonit, dhiakoni qëndron para Derës së Bukur, nga e djathta e priftit me Orarin të ngritur dhe kryet të ulur gjersa të mbarojë urata. Pastaj bën një përkulje para priftit dhe si merr bekimin, kthehet në Proskomidhi.

Psaltët: Emri i Zotit qoftë i bekuar, që tani e gjer në jetët (*tri herë*).

Prifti: (*pa zë*) U përfundua dhe u mbarua, sipas fuqisë sonë, Misteri i ikonomisë sate, o Krisht Perëndia ynë. Se patëm kujtimin e vdekjes sate; pamë tipin e ngjalljes sate; u mbushëm me jetën tënde të amëshuar; shijua mëfrimin tënd të pashterur, për të cilin me mirësinë tënde bëna të denjë ta shijojmë këtu dhe në jetën e ardhshme; me hirin e Atit tënd që s'ka fillim, dhe të Shpirtit tënd të Shenjtë, të mirë dhe jetëbërës, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Djaku: Le t'i lutemi Zotit.

Psaltët: Mëshiro, o Zot.

Prifti qëndron në mes të Derës së Bukur, bekon popullin, duke thënë:

Prifti: Bekimi dhe mëshira e Zotit ardh të mbi ju, me hirin e Tij hyjnor dhe njeridashjen, gjithnjë; tani e përherë e në jetë të jetëve.

Psaltët: Amin.

Prifti: Lavdi më Ty, o Perëndia ynë, lavdi me Ty.

Psaltët: Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë; tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Mëshiro, o Zot (*tri herë*).

Beko, o At i shenjtë (*ose* Zot i shenjtë, *në qoftë se meshon episkop*).

Pastaj prifti bën përlëshimin:

Prifti: Ai që u ngjall prej së vdekurish...

(Në qoftë se është e diel ose karakteristikën e të Krentës dhespotike)

Krishti, Perëndia ynë i vërtetë, me ndërmjetimet e Zonjës sonë të pacënuar Hyjlindëses dhe gjithmonë Virgjërës Mari; me fuqinë e Kryqit të çmuar dhe jetëbërës; me mbrojtjet e fuqive qiellore të çmuara dhe pa trup; të nderuarit, të lavdëruarit profet, pararendësit dhe pagëzorit Joan; të Apostujve të shenjtë, të lavdëruar dhe të dëgjuar; [të etërve tanë të shenjtë, mësuesve të mëdhenj ekumenikë dhe ierarkëve; të patrikëve të Aleksandrisë Athanasit, Qirillit dhe Joan Përdëllimtarit; të çudibërësve Shën Kollit, Kryepiskopit të Mirës së Liqisë, dhe Shën Spiridhonit, episkopit të Trimithundës], të martirëve të shenjtë, të lavdëruar dhe mundës të shkëlqyer; [të martirëve të shenjtë të lavdëruar e të mëdhenj, Gjergj Tropeprurësit, Dhimitër Mirovllit, Theodor Tironit dhe Theodor Stratillatit; të hieromartirëve të shenjtë dhe të lavdëruar Harallamb dhe Elefter, të Atit tonë ndër shenjtoret Vasilit të Madh, Kryepiskop i Qesarisë së Kapadhoqisë, të shenjtit (*aksh të Kishës*),] të etërve tanë oshënarë dhe hyjprurës, të

hyjprindërve të shenjtë dhe të drejtë Joaqim dhe Ana, të shenjtit (*aksh të ditës*) të cilin po lusim sot (*aksh*) dhe gjithë shenjtorëve të Tij, na mëshiroftë dhe na shpëtoftë si Perëndi i mirë, njeridashës dhe mëshirëplotë.

Me uratat e Etërve tanë të shenjtë, o Zot, Iisu Krisht Perëndi, mëshirona edhe shpëtona.

Psaltët: Amin.

Prifti bekon shpresëtarët duke thënë:

Prifti: Shen Trinia le t'u ruajë juve të gjithëve.

Psaltët: Atë që na bekon dhe na shenjteron, o Zot, ruaje për shumë vjet.

Prifti: (*duke bekuar*) Zoti Perëndia le të ruajë të gjithë ju me hirin dhe njëridashjen e Tij hyjnore, gjithnjë, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Pas përlëshimit të madh prifti ndan navorën, duke i thënë secilit:

Prifti: Bekimi dhe mëshira e Zotit ardhhtë mbi ju.

Dhe si mbaron së ndari navorën prifti thotë:

Prifti: Bekimi dhe mëshira e Zotit ardhhtë mbi yu, me hirin e tij hyjnor dhe njëridashjen, gjithnjë; tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Pastaj shkon në Poskomidhi dhe në qoftë se nuk ka dhiak, pi tepricën e kungatës që është në Potir, pastaj shplan Potirin me verë dhe pastaj me ujë, e fshin dhe i mbulon me Mbulesat dhe thotë falenderimin e kungatës. Pastaj prifti dhe dhiaku lajnë duart, dhe thonë troparin e Shën Simeonit:

Tani përlëshoje shërbëtorin tënd, o Zot, sipas fjalës sate, me paqe, se sytë e mi panë shpëtimin, të cilin Ti e përgatite faqe gjithë popujve, dritë për ndriçimin e paganëve dhe për lavdi të popullit tënd Izrael.

Shenjt Perëndi, Shenjt i fuqishëm, Shenjt i pavdekshëm, mëshirona (*tri herë*).

Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë; tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Trini e tërëshenjtë, mëshirona; o Zot, falna mëkatet tona; o Zot i madh, ndjei paudhësitë tona; o i shenjtë, vështro dhe shëro sëmundjet tona, për emrin tënd.

Mëshiro, o Zot (*tri herë*).

Ati ynë që je në qiejt, u shenjtëroftë emri yt, ardhhtë mbretëria jote, u bëftë dëshira jote, si në qiell ashtu edhe mbi dhe. Bukën tonë të përditshme jepna neve sot; dhe falna fajet tona, sikurse edhe ne ua falim fajtorëve tanë; dhe mos na shtjer në ngasje, po shpëtona nga i ligu.

Se jotja është mbretëria dhe fuqia dhe lavdia e Atit, e Birit dhe e Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Pastaj thonë përlëshoren e Shën Vasilit të Madh:

Tingulli I: Në tërë dhenë doli emri yt se e priti fjalën tënde, me anën e së cilës predikove, siç i ka hije Perëndisë, tregove natyrën e gjërave, zbukurove zakonet e njerëzve; Kryepriфт Shën Vasil, At oshënar, lutju Krishtit Perëndisë të shpëtohen shpirtat tanë.

U tregove themel i patronditur për Kishën, duke u dhënë gjithë njerëzve fuqinë të sigurt, duke e vulosur me mësimet e tua, oshënar Vasil, zbulues i mistereve qiellore.

Mëshiro, o Zot (*12 herë*)

Dhe zhveshin rrobat e Meshës.

Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë; tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin

Më të nderuarën se keruvimet dhe më të lavdëruarën pa

krahasim se serafimet, që pa u cënuar linde Fjalën Perëndi, me të vërtetë Hyjllindësen, ty të madhërojmë.

Dhe bën përlëshimin e vogël në këtë mënyrë:

Lavdi më Ty, o Perëndia ynë, lavdi më Ty.

Po të jetë e diel thotë:

Prifti: Ai që u ngjall së vdekurish...

Po të mos jetë e diel thotë:

Prifti: Krishti Perëndia ynë i vërtetë, me ndërmjetimet e Nënës së tij të pacënuar dhe krejt të papërlyer dhe të shenjtë, të etërve tanë oshënarë dhe hyjprurës, të hyjprindërve të shenjtë dhe të drejtë Joaqim dhe Ana dhe të gjithë shenjtorëve të tij, na mëshiroftë dhe na shpëtoftë si i mirë dhe njeridashës.

